



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

Fakulteti i Drejtësisë

Praven Fakultet

Law Faculty

**STUDIME PASDIPLOMIKE MASTER- CIKLI I DYTË**

**Tema:**

**“Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës- aspekte komparative”**

Kandidati:

Leonora Mustafi

Mentori:

Prof.dr.Emine Zendeli

Tetovë, 2018

**Tema:**

“Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit të martesës -  
aspekte komparative”

**Теза:**

“Имотно-правната положба на жената после разводот на бракот -  
компаративни аспекти”

**Thesis:**

“The Property-Law position of a Woman after the Divorce of the  
marriage - comparative aspects”

## **FALENDERIM**

Jam përzemërsisht faleminderuese mentores sime Prof.dr.Emine Zendeli, pa ndihmën e së cilës nuk do të kisha mundur të realizojë këtë punim. Një grua me ambicie të fortë, e cila me punën e saj, ka qenë shembull gjatë gjithë periudhës së studimeve të mija në Fakultetin Juridik, me komentet e saja për përmirësimin e çdo detaji në këtë temë, me përkrahjen e saj, motivimin, idetë dhe shumë tjera të cilat ajo më ka dhënë gjatë punimit të kësaj teme. Njohuritë e sajë të përgjithshme, si dhe ato konkrete, më kanë ndihmuar në përzgjedhjen e materialit të duhur për punim.

Gjithashtu faleminderoj prindërit e mij pa ndihmën morale dhe financiare të cilëve nuk do të kisha mundur të arrij qëllimet e mija si dhe të kryej studimet diplomike dhe pasdiplomike. Po ashtu faleminderit për motivimin e tyre që më kanë dhënë për të ndjekur rrugën e drejtësisë. Faleminderim i veçantë i takon edhe bashkëshortit tim, i cili më ka përkrahur gjatë punimit të temës.

Faleminderim të veçantë meritojnë të gjithë profesorët e drejtësisë, të cilët më kanë përcjellë në hapat më të rëndësishmë të jetës sime, pa të cilët nuk do të isha ku jam sot.

Faleminderoj gjithashtu edhe puntorët e Gjykatës Themelore të Tetovës, të cilët më ndihmuan gjatë realizimit të statistikave dhe praktikave gjyqësore, pa të cilët nuk do të kisha mundur të përfshijë material nga praktika në punim.

## SHKURTESAT

<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë
<b>RK</b>	Republika e Kosovës
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>KCSH</b>	Kodi Civil i Shqipërisë
<b>KFSH</b>	Kodi për Familjen i Shqipërisë
<b>LFK</b>	Ligji për Familjen i Kosovës
<b>LFM</b>	Ligji për Familjen i Maqedonisë
<b>LPDTS</b>	Ligji për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i Maqedonisë
<b>KLD</b>	Kanuni i Lekë Dukagjinit
<b>KL</b>	Kanuni i Labërisë

## Përmbajtja

HYRJE .....	1
KORNIZA METODOLOGJIKE .....	2
QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT .....	2
HIPOTEZA E HULUMTIMIT .....	3
METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT .....	4
KREU I PARË .....	6
1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës .....	6
1.1 Kuptimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe pozita e gruas .....	6
1.2 Regjimi pasuror i bashkëshortëve .....	8
KREU I DYTË.....	12
1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit përgjatë zhvillimit historik .....	12
1.1 E drejta Zakonore për regjimet pasurore martesore .....	12
KREU I TRETË.....	17
1. Shkurorëzimi i martesës dhe pasojat që rrjedhin nga shkurorëzimi i martesës .....	17
1.1 Shkurorëzimi i martesës.....	17
1.2 Pasojat që rrjedhin nga shkurorëzimi i martesës.....	19
KREU I KATËRT.....	21
1. Pozita juridike pasurore pas shkurorëzimit të martesës në sistemet juridike bashkëkohore .....	21
1.2 Regjimi pasuror ligjor .....	21
1.2 Regjimi pasuror i kontraktuar .....	22
KREU I PESTË.....	23
1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë .....	23
1.1 Regjimi pasuror i bashkëshortëve në dispozitat e Ligjit për pronësi dhe të drejta të tjera sendore (2001).....	24
KREU I GJASHTË.....	29
1. Ndarja e pronës së përbashkët të bashkëshortëve .....	29
1.1 Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve me marrëveshje.....	34
1.2 Ndarja gjyqësore e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve .....	35
1.3 Subjektet me të drejtë kërkesë për ndarje të pronësisë së përbashkët .....	43

1.4 Sendet e privileguara në ndarjen e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve.....	45
1.5 Pasojat e pushimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve .....	46
1.6 Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve .....	47
KREU I SHTATË.....	49
1. Mbajtja financiare dhe detyrimi për ushqim (ALIMENTACIONI).....	49
1.1 Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve gjatë martesës .....	50
1.2 Detyrimi i mbajtjes ndërmjet bashkëshortëve pas shkurorëzimit të martesës.....	52
1.3 Detyrimi në ushqim i prindërve të shkurorëzuar ndaj fëmijëve.....	58
1.4 Detyrimi i përfituesit të dhurimit .....	63
1.5 Pamundësia e dhënies së detyrimit për ushqim.....	64
1.6 Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim.....	65
1.7 Pushimi i detyrimit për ushqim.....	66
1.8 Procedura e detyrimit për ushqim .....	67
KREU I TETË.....	69
PËRFUNDIMI .....	69
Referencat .....	71

## HYRJE

Në shoqërinë bashkëkohore dukshëm është rritur numri i bashkëshortëve të shkurorëzuar. Edhe pse gjinia femërore ka fituar më shumë të drejta në krahasim me të kaluarën, duke arritur të barazohet me gjininë e kundërt ligjërisht, megjithëse praktikisht përsëri mbetet e nënçmuar. Nga një jetë e pakënaqur, ngjeshur me probleme të ndryshme, shpesh bashkëshortët vendosin që me anë të shkurorëzimit të zgjidhin martesën.

Shkurorëzimi i martesës paraqet mënyrën juridike të pushimit të martesës së plotëfuqishme ndërmjet bashkëshortëve. Martesa pushon me shkurorëzim atëherë kur aktgjykimi për shkurorëzim bëhet i plotëfuqishëm.<sup>1</sup>

Pronësia e fituar gjatë bashkësisë martesore quhet pronësi e përbashkët. Pronësia e tillë krijohet me punë të ndarë osë të përbashkët të bashkëshortëve gjatë martesës. Në rast të shkurorëzimit kjo pasuri e përbashkët duhet të ju ndahet bashkëshortëve në proporcion të caktuar sipas ligjit.

Punimi do të trajtojë: pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës, cilat janë metodat të cilat legjislatori ka parashikuar për ndarjen e pasurisë së përbashkët të ish-bashkëshortëve, përse janë parashikuar ato ligje për ndarjen e pasurisë së përbashkët, cilat janë pasojat e tyre në praktikë; regjimet pasurore të bashkëshortëve si ato të pasurisë së veçantë të bashkëshortëve edhe pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, regjimi pasuror ligjor si dhe regjimi pasuror i kontraktuar; pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit përgjatë zhvillimit historik, çfarë pozite juridiko-pasurore gruaja pas shkurorëzimit ka pasur në të kaluarën dhe çfarë ndryshime kanë pësuar në legjilacionin bashkëkohorë; detyrimet e bashkëshortëve pas shkurorëzimit, pasojat e shkurorëzimit, etj.

---

<sup>1</sup> Janevski Arsen, Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedurale civile- *E drejta kontestimore*, Shkup, 2009, fq.447

## **KORNIZA METODOLOGJIKE**

### **QËLLIMET DHE DETYRAT E HULUMTIMIT**

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të sqarojë se çfarë pozite juridiko-pasurore i përket bashkëshortes në rast të shkurrorëzimit të martesës, të përcaktojë, sqarojë dhe të hulumtojë vendin e saj në aspektin ligjorë, të jap informacion lidhur me të duke u bazuar në disa metoda, të sqarojë disa apekte krahasuese në lidhje me këtë temë, si dhe në bazë të disa të dhënave të sqarojë gjendjen aktuale të bashkëshortes në rast shkurrorëzimi të martesës.

Detyrat e hulumtimit janë të jepet informacion në lidhje me:

- Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit të martesës
- Kuptimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe pozita e gruas
- Regjimi pasuror i bashkëshortëve
- Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit të martesës përgjatë zhvillimit historik
- Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit të martesës në sistemet juridike bashkëkohore
- Regjimi pasuror ligjor dhe i kontraktuar
- Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit të martesës në sistemin juridik të RM-së sipas LPDTS
- Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve
- Mënyrat e ndarjes së pronësisë së përbashkët
- Procedurat e ndarjes së pronësisë së përbashkët
- Subjektet të cilët kanë të drejtë në ndarjen e pasurisë së përbashkët
- Pasojat e pushimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve
- Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve



## **HIPOTEZA E HULUMTIMIT**

1. Çfarë ndryshimi ka pësuar pozita juridiko-pasurore e gruas përgjatë historisë?
2. Sa zbatohet Parimi i barabarësisë në Republikën e Maqedonisë në aspektin e ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve?
3. Në favor të cilës palë anon më shumë Ligji i Republikës së Maqedonisë gjatë rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve?
4. Sa është e rëndësishme që të informohemi rreth pozitës juridiko-pasurore të bashkëshortes pas shkurrorëzimit?
5. Çfarë garance paraqesin normat e Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë lidhur me pozitën juridiko-pasurore për bashkëshorten pas shkurrorëzimit?
6. Cila është mënyra e zgjidhjes së problemit aktual përgjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve?

## METODAT SHKENCORE TË HULUMTIMIT

Me qëllim të vërtetimit të hipotezave dhe arritjen e konkluzioneve që do të nxjerr në përfundim të punimit, do të shfrytëzohet disa metoda me të cilat do të realizohet qëllimet e theksuara në këtë punim. Si metoda të tilla do të përdoren: metodën teorike dhe atë empirike, nëpërmjet këtyre metodave do të analizohen rregullat juridike qoftë të vendit apo të huaj, pastaj gjithashtu do të analizohet edhe zhvillimi i ligjeve juridike me të cilat rregullohet pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurrorëzimit në të drejtën familjar si domosdoshmëri apo realitet i legjislacionit. Gjithashtu do të nxirren edhe pikat e përbashkëta dhe ato dalluese nga analiza e detajuar si në Republikën e Maqedonisë, në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë, etj. Përveç kësaj nëpërmjet këtyre metodave punimin tim do ta kurorëzoj edhe me disa të dhëna të cilat do të ndihmojnë që të shohim se si është gjëndja në vendin tonë.

### **A: Si metodë teorike do të përdoret:**

1.METODËN NORMATIVE: si një ndër metodat më të rëndësishme e sidomos kur kemi të bëjmë me analizën e procedurave gjyqësore, me ç'rast do të përdoret për analizat e rregullave pozitive juridike të vendit dhe të huaj.

2.METODËN KOMPARATIVE: e cila do të aplikohet me qëllim të studimit më të mirë të pozitës juridiko-pasurore të gruas pas shkurrorëzimit. Gjithashtu këtë metodë do ta përdor me qëllim të studimit sa më të mirë dhe krahasues të rregullave juridike të vendit dhe të huaja me ç'rast do të mundohem të nxjerrë pikat pozitive, negative si dhe ato të përbashkëta dhe dalluese në mes tyre.

3.METODËN HISTORIKE: si metodë e pashmangshme e cila përdoret në shumë punime të ndryshme shkencore, gjithashtu edhe në këtë punim kjo metodë do të zërë vend të rëndësishëm gjatë analizave dhe studimit të pozitës juridiko-pasurore të gruas pas shkurrorëzimit që nga kohërat më të hershme e deri në ditët e sotëshme në RM dhe në shtetet e huaja.

4. METODËN E DEDUKSIONIT: do të përdoret me qëllim që nëpërmjet kësaj metode të arrijë deri në konstatime të sakta. Pra, me anë të kësaj metode, nga konstatime të përgjithshme do të mundem të arrij në konstatime konkrete. Përveç metodës së deduksionit do të përdor edhe

metodën analoge të saj metodën e induksionit nëpërmjet së cilës nga konstatime konkrete do të mundem të nxjerr konstatime të përgjithshme.

**B: Si metoda empirike do të përdor:**

1.METODËN STATISTIKORE: të cilën do ta përdor me qëllim që të përfitoj një pasqyrim sa më të mirë të gjendjes pozitive juridiko-pasurore të gruas pas shkurorëzimit në vendin tonë dhe në vendin e huaj duke bërë hulumtime dhe krahasime mbi këtë çështje.

2.METODA E ANALIZËS SË DOKUMENTACIONIT: të akteve juridike, ligjet, kodin, si dhe aktvendime të ndryshme, materiale dhe literatura tjera të ndryshme, të njëjtat si të vendit ashtu dhe të huaj. Republika e Maqedonisë sferën e ndarjes së pronës së përbashkët të bashkëshortëve e rregullon me Ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore, Republika e Kosovës të njëjtën sferë e rregullon me Ligjin për Familje, ndërsa Republika e Shqipërisë me Kodin e Familjes. Me anë të kësaj metode do të arrijmë të kuptojmë dhe të mësojmë shkaqet, arsyet dhe rëndësinë e sjelljes dhe ekzistimit të tyre dhe pasojat juridike të sjelljes dhe ekzistimit të tyre.

## **KREU I PARË**

### **1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës**

#### **1.1 Kuptimi i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe pozita e gruas**

Nocioni pasuri, paraqitet si kategori e komplikuar e të drejtës civile, autorë dhe ligje të ndryshme nuk bëjnë dallimin mes nocioneve pasuri dhe pronësi, ndër to bën pjesë edhe Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i Republikës së Maqedonisë.

Pasuria si lëndë ka sendet dhe vlerat ekonomike, ajo paraqet tërësi të të drejtave subjektive civile me karakter pasuror që i takojnë një personi. Pasuria është kategori evolutive, ajo ndryshon dhe varet nga rentabiliteti apo jorentabiliteti, sukcesi apo mosukcesi i punës që ushtron titullari. Në pasuri hyjnë e drejta e pronësisë, e drejta e servitutit dhe barat sendore, po ashtu edhe të drejtat e detyrimeve si dhe të drejtat subjektive civile me karakter absolut, siç janë e drejta e autorit, të drejtat nga pronësia industriale dhe të drejtat e ngjajshme.<sup>2</sup>

Martesa është një bashkim vullnetar, i përjetshëm, midis një burri dhe një gruaje.<sup>3</sup> Përgjatë ekzistimit të martesës, bashkëshortët me anë të kontributit të tyre krijojnë atë të cilën konsiderohet si pronësi e përbashkët e bashkëshortëve. Megjithëse martesa jo gjithmonë është e përjetshme, bashkëshortët nga jeta e padurueshme ose e pakënaqur bashkëshortore në martesë, e përfundojnë martesën me zgjidhjen e saj apo thënë ndryshe me shkurorëzim të martesës.

Me qëllim për të kërkuar një shkurorëzim duhet që të ekziston bashkësi martesore sipas ligjit. Numri i bashkëshortëve të shkurorëzuar është rritur shumë. Vitet e fundit shumica e bashkëshortëve pas martesës së tyre të pakënaqur dhe të padurueshme, përfundojnë me shkurorëzim. Shkurorëzimi është procedurë e lehtë, por pasojat që sjell janë shumë të vështira. Pasi gratë gjithmonë kanë pasur vështirësi dhe përbuzje në drejtësi, është shumë më rëndësi të dihet se si trajtohet juridikisht në jetën bashkëkohore.

Efekti juridiko-pasuror i gruas pas shkurorëzimit, nënkupton atë se pas zgjidhjes së martesës, juridikisht se si ndahet pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe çka konsiderohet si

---

<sup>2</sup> Verdish Martin-Klaric Petar, Gragjansko parvo, Zagreb, 1998, fq.95

<sup>3</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.82

kontribut në pasurinë e përbashkët nga bashkëshortët, si dhe çka i përket gruas nga ajo pasuri e përbashkët duke u bazuar në ligj. Shumë rrallë bashkëshortët kanë njohuri rreth pasurisë së përbashkët të tyre, deri sa ballafaqohen me mosmarrëveshjet bashkëshortore apo pas zgjidhjes së martesës ata fillojnë të krijojnë njohuri rreth gjendjes së tyre pasurore. Këto çështje rregullohen me dispozita të veçanta, ku në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Ligjin për Pronësi dhe të drejta tjera sendore, në Republikën e Kosovës me Ligjin për Familje, si dhe në Republikën e Shqipërisë me Kodin për Familje.

Në pasurinë e bashkëshortëve përfshihen të drejtat subjektive civile me karakter pasuror, sikurse janë: 1. të drejtat sendore: e drejta e pronësisë mbi sendet e luajtshme (të hollat, stollitë, mobiljet, aparatet, mjetet motorike etj.), dhe të paluajtshme (tokat, ndërtesat, lokalet afariste etj.), e drejta e pengut, e drejta e servitutit, e drejta e barës sendore; 2. të drejtat detyrimore, respektivisht kërkesat që dalin prej tyre, 3. të drejtat e autorit, 4. të drejtat e pronësisë industriale dhe të drejtat e ngjajshme.<sup>4</sup>

Pika kryesore e cila lidhë bashkëshortët në martesë është pasuria e përbashkët e tyre, e cila paraqitet si problematikë gjatë shkurorëzimit të martesës, pasi që pasuria e përbashkët e bashkëshortëve në rast të shkurorëzimit të martesës duhet që të ndahet vlера pasurore dhe të krijohet pasuria e veçantë e bashkëshortëve.

Gjinia femrore shumë vështirë e ka pasur për të fituar këto të drejta që ka sot, formalisht, mirëpor ajo nuk ka arritur që të konsiderohet e barabartë me gjininë e kundërt, realisht apo në praktikë. Ajo që na intereson më shumë është që të kemi njohuri se si mbrohen të drejtat nga ana e Kushtetutës dhe çka përcakton ligji në lidhje me efektin juridiko-pasuror të gruas pas shkurorëzimit.

---

<sup>4</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualëve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.2

## 1.2 Regjimi pasuror i bashkëshortëve

Regjimi juridik i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve rregullohet në mënyra të ndryshme edhe atë: rregjimi pasuror ligjor dhe rregjimi pasuror i kontraktuar. Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë njihet si regjim pasuror i bashkëshortëve.<sup>5</sup>

Në legjislacionet që zbatojnë vetëm regjimin pasuror ligjor, pra, legjislacionet që nuk parashikojnë regjimin e kontraktuar të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve (siç është legjislacioni i Republikës së Maqedonisë si dhe ai i Republikës së Kosovës), bashkëshortët kanë vetëm një zgjidhje. Ata janë të detyruar që t'i nënshtrohen regjimit të përcaktuar me ligj, dhe marrëdhëniet pasurore të tyre t'i rregullojnë sipas regjimit pasuror ligjor, pa pasur të drejtë që me kontratë të merren vesh për ndonjë regjim tjetër alternativ.<sup>6</sup> Regjimi pasuror ligjor në një farë mënyre i kufizon bashkëshortët, duke mos lejuar ata që të merren vesh për ndonjë lloj tjetër të regjimit, megjithëse i kufizon bashkëshortët që t'i nënshtrohen regjimit të caktuar ligjor.

Në legjislacionet që përveç regjimit pasuror ligjor njohin edhe regjimin e kontraktuar, (Franca, Austria, Gjermania, Zvicra, Belgjika, Holanda, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Spanja, Portugalia, Shqipëria, Kroacia etj.), bashkëshortët mund të shmangin regjimin pasuror ligjor, dhe të përcaktohen për ndonjë regjim tjetër alternativ.<sup>7</sup> Në këto shtete bashkëshortët me kontratë merren vesh lidhur me pasurinë që do ta krijojnë gjatë martesës. Që nënkupton se në krijimin e asaj pasurie secili bashkëshort do ta kishte pasurinë e veçantë dhe në rast se nuk do të ishte kjo marrëveshje pasuria e tyre e krijuar do të konsiderohet si pasuria e përbashkët apo pasuria bashkëpronësi në pjesë të barabarta. Në vendet në të cilat zbatohet regjimi i kontraktuar, nëse palët nuk kanë përcaktuar ndonjë regjim pasuror të kontraktuar, atëherë automatikisht palët do t'i nënshtrohen regjimit pasuror ligjor.

Sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë është sistem i cili e njeh rregjimin pasuror ligjor, si dhe nuk e njeh rregjimin pasuror kontraktues, kështu që bashkëshortët janë të detyruar

---

<sup>5</sup> Gelevski Sllavko, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, so komentar I sudska praktika, Skopje, 2002, fq.140

<sup>6</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualeve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.3

<sup>7</sup> Po aty, fq.3

të zbatojnë rregjimin pasuror ligjor të përfshirë në nenin 66-80 të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore, të vitit 2001, bashkëshortët nuk kanë të drejtë dhe mundësi që këto marrëdhënie t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre, apo ti rregullojnë ndryshe por vetëm duke u obliguar në respektimin e regjimit ligjor. Por ajo që ata mund të meren vesh me kontratë është vetëm mënyra e administrimit dhe disponimit të pronësisë së përbashkët dhe të pasurisë së veçantë të përcaktuar me këtë ligj.<sup>8</sup>

Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve mund të jetë: e përbashkët dhe e veçantë.

Ligji i Maqedonisë pronësi dhe të drejta tjera sendore përcakton se pronën të cilën bashkëshortët do ta fitojnë gjatë martesës paraqet pronësi të përbashkët të tyre.<sup>9</sup> Që nënkupton pasurinë e fituar gjatë martesës si dhe të hyrat që dalin nga ajo pasuri, konsiderohen pasuri e përbashkët e bashkëshortëve. Bashkëshortët gjatë ekzistimit të martesës mund të krijojnë pasurinë e tyre të përbashkët si dhe pasurinë e tyre të veçantë.

Ligji i Familjes i Republikës së Kosovës në nenin 47 përcakton se çka quhet pronë e përbashkët, ku thekson se pasuri e përbashkët është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin apo burojnë nga pasuria e tillë, edhe pasuria e fituar bashkërisht përmes lojrave të fatit, paraqet pasuri të përbashkët të bashkëshortëve.

Pronën të cilën njëri nga bashkëshortët e ka pasur para se të hyjë në bashkësinë martesore paraqet pronën e tij të veçantë. Pasuria e veçantë është ajo pasuri të cilën bashkëshorti e fiton para lidhjes së martesës ose gjatë ekzistimit të martesës e fituar jo me punë por me trashëgim me dhurim, etj. Kjo dispozitë edhe po të mos ishte e garantuar me ligj, konkretisht me nenin 68 të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore të Republikës së Maqedonisë, nënkuptohet vetvetiu ngase të drejtat pronësore që një subjekt i së drejtës i ka, duhet të jetë e përcaktuar mënyra se si ato do të humben apo barten në një subjekt tjetër.

Neni 68 i Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore të Republikës së Maqedonisë thekson se: "Pasurinë, të cilën njëri prej bashkëshortëve e ka pasur në kohën e lidhjes së martesës paraqet pasurinë e tij të veçantë. Si pasuri e veçantë do të llogaritet edhe pasuria edhe e drejta

---

<sup>8</sup> Neni 68,70, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligji për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>9</sup> Neni 67, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

mbi pasurinë, të cilën bashkëshorti do ta fitojë në bazë të trashëgimisë, legut dhe dhuratës si dhe sendet e fituara gjatë martesës, por që shërbejnë për kënaqjen e kërkesave personale të njërit prej bashkëshortëve, nëse nuk paraqesin vlerë në disproporcion të madh në krahasim me vlerën e tërë pronësisë së përbashkët. Secili bashkëshort pavarësisht administron dhe disponon me pronësinë e tij të veçantë nëse bashkëshortët në mënyrë të shkruar nuk janë marrë vesh ndryshe.” Lidhur me këtë të drejtë është shembulli prej praktikës gjyqësore nga Gjykata Supreme e RM-së, e cila përfshinë bashkëshortin i cili ka rënuar shtëpinë para lidhjes së martesës, ku bashkëshorti tjetër nuk e fiton të drejtën si pronësi e përbashkët e bashkëshortëve mbi atë shtëpi.<sup>10</sup>

Ja vlenë të përmendet fakti se në praktikën gjyqësore ceken disa rregulla bazë mbi dhuratat e marra në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës dhe më vonë, gjegjësisht dhuratat të cilat i jepen për të lehtësuar jetën bashkëshortore, i takojnë njëres palë apo tjetrës. Këto rregulla janë:

- Nëse dhurata i jepet njërit bashkëshort, atëherë ajo paraqet pronë të veçantë të tijë;
- Nëse dhurata i jepet të dyve, atëherë ajo konsiderohet si pronë e përbashkët e tyre;
- Nëse gjatë dhurimit, dhuratë-dhënësi nuk e përcakton se kujt ia jep dhuratën, ndërsa ajo jepet nga ana e shokëve të përbashkët, konsiderohet se u jepet të dyve, edhe nëse jepet nga ana familjare të bashkëshortëve
- Nëse dhurata jepet me qëllim që të lehtësohet jeta bashkëshortore, si ndihmë nga ana e familjarëve të njëres palë dhe në qoftë se dhurata ka vlerë të konsiderueshme atëherë konsiderohet se paraqet pronë të veçantë e atij partneri bashkëshortor të cilit i është dhënë dhurata nga ana e familjarëve të tij, duke mos cekur gjatë aktit të dhurimit se dhurata i jepet ekskluzivisht njërit prej tyre.<sup>11</sup>

Sipas nenit 77 të KFSH-së si pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

- pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;
- pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;

---

<sup>10</sup> Micković Dejan, Ristov Angel, Semejno Pravo, Skopje, 2015, fq.325



- pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesore të pasurisë vetjake;
- mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;
- pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;
- pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.

E drejta e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve mbi paluajtshmërinë duhet që të regjistrohet në librat publik në emër të të dy bashkëshortëve si pronë e përbashkët e tyre. Regjistrimi në librat publik bëhet vetëm që të dihet kush është titullar apo pronar i pronës së përbashkët. Nëse në regjistrat publik janë të nënshkruar të dy bashkëshortët si pronar të pjesëve të caktuara, do të konsiderohet se në këtë mënyrë ato i kanë përcaktuar pjesët në pronësinë e tyre të përbashkët.<sup>12</sup>

Ekzistojnë raste kur bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në pasurinë e përbashkët të tyre. Kur bashkëshortët nuk arrijnë marrëveshje lidhur me pjesën e përbashkët atëherë këtë e zgjedh gjykata si organ shtetëror. Këtë rregullativë e parasheh LPDTS i RM-së<sup>13</sup>, Kodi Civil i Shqipërisë<sup>14</sup>, Ligji për Familje i Kosovës<sup>15</sup>, etj. Vendimi i gjykatës bazohet në kontributin e bashkëshortëve. Ajo i merr parasysh gjitha rrethanat, edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve ofruar prej bashkëshortit tjetër, e jo vetëm të ardhurat personale të bashkëshortëve, dhe kjo më detajisht do të trajtohet në kapitullin e ardhshëm, pra tek ndarja e pronës së përbashkët.

---

<sup>12</sup> Neni 69, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore të RM-së, 2001

<sup>13</sup> Neni 75 “Nëse nuk vjen deri tek marrëveshja, ndarja e pasurisë së përbashkët me kërkesë të njërit nga bashkëshortët e bën gjykata në procedurë jokontestimore.”

<sup>14</sup> Neni 54, Par.1, “Gjykata do të vendosë për pjesët e tyre nga pasuria e përbashkët në qoftë se këtë nuk e kanë bërë me marrëveshje bashkëshortët deri sa kanë pasur kohë, e kjo do të thotë gjatë ekzistimit të pronësisë së përbashkët të tyre.”

<sup>15</sup> Neni 54, LFK, nr.2004/32

## **KREU I DYTË**

### **1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit përgjatë zhvillimit historik**

Në të kaluarën përveçse gruaja nuk ka qenë e barabartë me gjininë e kundërt, ajo ka qenë e nënshtruar si në aspektin shoqëror, fetar, po ashtu edhe në atë ligjor. Legjislacionet si të epokës së vjetër ashtu edhe të epokës mesjetare, aspak nuk kanë pasur konsideratë ndaj gruas. Në të kaluarën përveçse nuk e kanë pasur në konsideratë gruan, shpesh gruan e kanë vënë në pozitën e skllavit ose të sendit të thjeshtë. Mirëpo, me zhvillimin shoqëror, të drejtat e gruas kanë ndryshuar dhe janë përmisuar në një masë të madhe. Në të kaluarën, gruaja nuk kishte të drejtë në arsimim, punësim, shkurorëzim, pronësi, etj., të cilën në shoqërinë bashkëkohore dukshëm këta të drejta kanë pësuar një ndryshim të madhë në favor të dy gjinive. Edhe pse gruaja shqipëtare formalisht ka fituar shumë të drejta dhe është barazuar me gjininë mashkullore në krahasim me të kaluarën, në praktikë gruaja përsëri përballlet me problematikën e së kaluarës, respektivisht mentalitetit shqipëtarë. Sa i përket mentalitetit shqipëtarë, gruaja në shumicën e rasteve ngelet amvise, si dhe nuk është e pavarur në aspektin financiar, fakt ky që ndikon në ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

#### **1.1 E drejta Zakonore për regjimet pasurore martesore**

Në të kaluarën pushimi i martesës me shkurorëzim krijonte probleme mbi ruajtjen e fëmijëve si dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët apo marrjen e pasurisë që i takonte gruas të marrë nga ish-bashkëshorti. Andaj për zgjidhjen e këtyre problemeve krijuan të drejtat zakonore shqipëtare të cilat ishin në favor të burrit.

Gruas nuk i njihej asnjë pjesë në pasurinë e përbashkët të familjes, asnjë kontribut, si në pasurinë e luajtshme ashtu edhe në atë të paluajtshme.<sup>16</sup> Si rregull, gruaja merrte me vete vetëm teshat e shtatit.<sup>17</sup> Sipas Kanunit të Lumës, gruaja pa fëmijë merrte edhe teshat e arkës si dhe ato

---

<sup>16</sup> Xhaferi Pranvera, Evoluimi i Regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqipëtare. Rezultatet dhe Objektivat, Tiranë, 2010, fq.3

<sup>17</sup> Po aty, fq.3

që kishte punuar vetë. Gruaja me fëmijë merrte vetëm teshat e shtatit; ato të arkës ju mbeteshin fëmijëve, shtresat e mbulesat burrit.<sup>18</sup>

### 1.1.1 Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, gruaja “asht shakull për me bajtë”.<sup>19</sup> Gruaja ishte një amvise për të kryer vetëm punët e shtëpisë, si në shtëpinë e të atit, po ashtu edhe në shtëpinë e burrit. Sipas KLD, gruaja ishte një qenie inferior, pronë e burrit, i cili ishte “kreu i shtëpisë”.<sup>20</sup> Gruaja konsiderohej për asgjë, pozita e saj ishte shumë e ulët duke parë dhe duke u bazuar në normat zakonore shqiptare. Ajo nuk kishte asnjë të drejtë, as mbi fëmijët as mbi shtëpinë. Gjithashtu gruaja nuk gëzonte të drejta trashëgimore mbi pasurinë e lënë nga prindi apo nga burri.<sup>21</sup>

Arsyet e ndarjes mund të ishin shkelja e besnikërisë bashkëshortore dhe marrja në qafë ose pabesia që gruaja mund të tregonte ndaj mikut që vinte në shtëpi. Në këtë rast ajo vritej nga i shoqi.<sup>22</sup> Për vjedhje ai thjesht e ndante dhe me kanun nuk kishte të drejtë të ushtronte asnjë dhunë mbi të. Por në këtë rast kur ai e lëshonte gruan, kjo e fundit nuk merrte asnjë send me vete përveç teshave që kishte të veshura në ato çaste.<sup>23</sup>

Gjithashtu Kanuni i Lekë Dukagjinit parasheh edhe pozitën e gruas së ve apo të pa fëmijë e cila shkurorëzohet nga burri saj. Në rastin kur gruaja mbetej e ve dhe akoma nuk kishte bërë asnjë fëmijë, ajo duhej të largohet nga dera e burrit dhe merrte me vete “petkat, që i pat pru si nuse e arkën me dry i merr me vedi”.<sup>24</sup> Në bazë të kësaj gruas nuk i takon asgjë nga pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, gruas i takon vetëm pasuria e veçantë të cilën e ka sjellur vetë në martesë. Në rast rimartese të saj, ajo nuk merrte asgjë nga pasuria sepse sipas Kanunit “Toka e burrit të parë s’qet bimë ma për të”.<sup>25</sup>

---

<sup>18</sup> Neni 829-831, Kanuni i Lumës

<sup>19</sup> Gjecovi Shtefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, fq.19

<sup>20</sup> Begeja Ksanthipi, E drejta familjare e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985, fq.33

<sup>21</sup> Gjecovi Shtefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, fq.26

<sup>22</sup> Po aty, fq.20

<sup>23</sup> Po aty, fq.20

<sup>24</sup> Po aty, fq.20

<sup>25</sup> Xhaferi Pranvera, Evoluimi i Regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqipëtare. Rezultatet dhe Objektivat, Tiranë, 2010, fq.4

### 1.1.2 Sipas Kanunit të Labërisë

Sigurisht, nuk mund të mohohet, që edhe në shoqërinë e sotme të ish-Labërisë ndeshen në praktikë dukuri të Kanunit, sidomos në marrëdhëniet familjare e martesore, në marrëdhëniet civile, të detyrimeve e të kontratave të cilat lidhen në mirëbesim, me gojë, kur duhen me shkrim e deri në fushën penale e procedurale, duke përjashtuar gjakmarrjen, e cila në Labëri i përket së kaluarës.<sup>26</sup>

Edhe sipas Kanunit të Labërisë, gruaja ka pasur një pozitë të vështirë familjare dhe pasurore. Pozita e saj me burrin ka qenë jo e barabartë në çdo aspekt bashkëshortor. Duke filluar nga vlera që i jepej gjakut të saj ku ajo do të barazohet me gjysmën e vlerës së gjakut të burrit, e duke vazhduar në marrëdhëniet familjare, martesore, ekonomike e shoqërore ku burri do të gëzonte më shumë privilegje ndaj gruas.<sup>27</sup> Si në Kanunin e Labërisë, po ashtu edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, si në martesë po ashtu edhe pas shkurorëzimit të martesës, gruaja nuk është konsideruar si e barabartë me burrin. Ajo gjithmonë i është nënshtruar burrit.

Sipas Kanunit të Labërisë gruaja pas shkurorëzimit nuk mund ta merrte fëmijën pasi ai ishte i burrit, nuk kishte asnjë të drejtë të trashëgonte as te babai as te burri dhe në asnjë mënyrë ajo nuk merrte pjesë në shitblerjet e pronave.<sup>28</sup>

Gjatë kërkesës për ndarjen nga bashkëshorti gruaja e kishte pak më lehtë në krahasim me ndarjen sipas KLD. Gruaja kishte të drejtë për të kërkuar ndarjen, dhe këtë vetëm në marrëveshje me babanë e saj, në rastet e shkeljes së kurorës nga burri ose kur ai kishte tentuar ta vriste apo kur kishte të meta fizike/psikike.<sup>29</sup>

Në të njëjtën kohë, shohim një farë “lirimi” të të drejtave të gruas përsa i përket dhuratave të nusërisë pasi në Kanunin e Labërisë gruaja e martuar i kishte në pronësinë e vet të gjitha ato, në ndryshim nga Kanuni i Lekë Dukagjinit. Por në të njëjtën kohë edhe pasuria e tyre bashkëshortore ishte në duart e burrit me përjashtim të dhuratave të mësipërme. Këtu shohim që

---

<sup>26</sup> Xhaferi Pranvera, Evoluimi i Regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqipëtare. Rezultatet dhe Objektivat, Tiranë, 2010, fq.5

<sup>27</sup> Elezi Ismet, Kanuni i Labërisë, fq.39

<sup>28</sup> Po aty, fq.39

<sup>29</sup> Po aty, fq.123

të dy janë përgjegjës për ruajtjen, zhvillimin dhe shtimin e kësaj pasurie.<sup>30</sup> Por, administrimi i saj mbetet gjithmonë në tagrin e burrit.<sup>31</sup>

Sipas KLD, kur gruaja largohet nga shtëpia, vritej nga burri, për dallim nga Kanunit të Labërisë ku në rast se gruaja largohet nga shtëpia, largimi i saj konsiderohet sjellje jo e mirë dhe e turpshme për familjen e burrit në bazë të zakonit, si dhe vendoset që t'i pritej hunda ose veshi, ose të pëson ndonjë dënim penal.<sup>32</sup>

Gruaja e ndarë, me ose pa fëmijë, merrte rrobat e trupit, ndonëse ato ishin blerë nga burri, pajën e sjellë me vete, si dhe dhuratat që i ishin bërë para ose pas martesës.<sup>33</sup>

### 1.1.3 Sipas Sheriatit

Në të drejtën islame ekziston shkurorëzim më të drejtë kthimi si dhe shkurorëzim përfundimtarë. Sa i përket shkurorëzimit më të drejtë kthimi në Kuran është paraparë “Lëshimi (pas së cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore) ose shkurorëzim me mirëkuptim. Në Kuranë është theksuar: “E juve (burrave) nuk u lejohet t’u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah), vetëm nëse që të dy frikësoheni se nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e All-llahut (në bashkëshortësi). E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t’i ruajnë dispozitat e All-llahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim për shkurorëzim (hule), për ata të dy nuk ka mëkate.”

Ndërsa sa i përket shkurorëzimit përfundimtar në Kuran është paraparë “E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata dy, po qe se mendojnë se do t’i zbatojnë dispozitat e All-llahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozita të All-llahut që i’a sqaron një populli që kupton.<sup>34</sup>

Sipas shkurorëzimit përfundimtarë, gruaja ka këto të drejta:

---

<sup>30</sup> Xhaferi Pranvera, Evoluimi i Regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqipëtare. Rezultatet dhe Objektivat, Tiranë, 2010, fq.6

<sup>31</sup> Elezi Ismet, Kanuni i Labërisë, fq.122

<sup>32</sup> Po aty, fq.123

<sup>33</sup> Xhaferi Pranvera, Evoluimi i Regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqipëtare. Rezultatet dhe Objektivat, Tiranë, 2010, fq.7

<sup>34</sup> Ajeti 230, Kur’an, Suretu El Bekare

- burri ka detyrim që t’ia dorëzon mehrin<sup>35</sup> gruas
- gruaja duhet që pas shkurorëzimit, të respektohet nga burri gjatë dorëheqjes nga martesë, ku në Kuran parashihet “Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni gratë pa pasur kontakt (martesë) me to dhe para se t’u caktoni atyre ndonjë caktim (kurorë-nikah), po pajisni ato (me ndonjë pajisje), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme është obligim për bëmirsit.”<sup>36</sup>
- nëse gruaja nga pasuria e saj personale e veçantë ka kontribuar për sende në shtëpi të burrit, burri është i detyruar që të bëjë kthimin e atyre sendeve.
- as burri as gruaja nuk kanë të drejtë të publikojnë arsyet e ndarjes së tyre
- në qoftë se bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, fëmija i takon nënës, më kusht se ajo nuk do të martohet sërish, nëse nuk e përmbush kushtin, atëherë nuk do ti takon kjo e drejtë e mbajtjes së fëmijës
- bashkëshorti është i detyruar që të kujdeset për alimentacion ndaj fëmijës, por jo edhe ndaj gruas
- gruaja është e lirë pas shkurorëzimit të martohet, nuk ka të drejtë që ish-bashkëshorti ta pengojë këtë të drejtë.

Këta të drejta sipas të drejtës islame, janë të drejta që anojnë më shumë në anën e burrit, nga të cila të drejta duke shiuar dhe analizuar shumë lehtë mund të bëjmë dallimin në mes ligjeve si në të drejtën e RM-së, po ashtu edhe me të drejtën e Kosovës dhe të Shqipërisë. Mirëpo, bashkëshortes pas shkurorëzimit i ka takuar pasuria e saj e veçantë të cilën e ka sjellur gjatë martesës. Gjithashtu në të drejtën islame, përcaktohet që pas shkurorëzimit burri duhet që t’i jep ndonjë pjesë nga pasuria e vet, i varfëri në bazë të mundësisë si dhe i pasuri në bazë mundësisë, ku e përcakton këtë si bëmirsit. Pas shkurorëzimit fëmija i takon nënës, nëse ajo lidhë një martesë të re, atëherë fëmija nuk do ti takon nënës, por babait. Megjithëse, alimentacion pas shkurorëzimit bashkëshorti ka të drejtë të paguaj vetëm për fëmijën, ndërsa jo për bashkëshorten.

<sup>35</sup> Mehri është dhurata martesore që duhet burri t’ia jep gruas në martesë.

<sup>36</sup> Ajeti 236, Kur’an, Suretu El Bekare

## KREU I TRETË

### 1. Shkurorëzimi i martesës dhe pasojat që rrjedhin nga shkurorëzimi i martesës

#### 1.1 Shkurorëzimi i martesës

Shkurorëzimi është paraqitur që nga kohërat e lashta. E njohën dhe e rregulluan si e drejta romake, ajo greke, bizantine, etj., ashtu edhe e drejta zakonore shqiptare. Në Shqipëri, veçanërisht gjatë sundimit Osman, zgjidhja e martesës ishte dukuri mjaftë e rrallë, për shkak të rrethanave dhe kushteve ekonomiko-shoqërore në të cilat ndodhej shoqëria shqiptare, dhe për shkak të mendësisë dhe karakterit patriarkal të marrëdhënieve martesore.<sup>37</sup>

Ndërsa ditëve të sotme, shkurorëzimi ka arritur në një rritje shumë të madhe dhe rregullohet nga të gjithë legjislacionet. Shkurorëzimi nënkupton ndarjen e bashkëshortëve apo zgjidhjen e martesës së vlefshme të bashkëshortëve për arsye të parapara me ligj dhe procedura ligjore, me aktgjykim të gjykatës. Me shkurorëzim zgjidhet vetëm martesa e vlefshme, dhe kjo është veçori tipike e shkurorëzimit. Martesa e pavlefshme nuk zgjidhet, por anulohet.<sup>38</sup>

Sikurse që është e mundur lidhja e martesës, është e mundur edhe zgjidhja e saj, gjithmonë e bazuar në ligj. Shkurorëzimi është zgjidhje e një martese të vlefshme.<sup>39</sup> Shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e një martese të plotfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të parashikuara me ligj.<sup>40</sup> Sipas LFK, neni 60, paragrafi 1 parasheh “martesa shuhet me vdekjen e bashkëshortit, shpalljen e bashkëshortit të zhdukur të vdekur, anulimit dhe shkurorëzimit”.<sup>41</sup> Të njëjtën e parasheh Ligji për Familjen i RM-së në nenin 34 paragrafi 1.<sup>42</sup> Shkurorëzimi i martesës mund të bëhet nga bashkëshortët. Gjatë jetës bashkëkohore, numrit i shkurorëzimit të martesës është gjithmonë në rritje.

---

<sup>37</sup> Podvorica Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005, fq.116

<sup>38</sup> Po aty, fq.120

<sup>39</sup> Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, fq.176

<sup>40</sup> Po aty, fq.158

<sup>41</sup> Neni 60, parag.1, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>42</sup> Neni 34, parag.1, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së, “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014 “Martesa pushon me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulim dhe me shkurorëzim të martesës”

Nga viti 2009, Agjencia e Statistikave të Kosovës grumbullon këto të dhëna me pyetësor statistikor të veçantë, për shkurorëzime nga ish Gjykatat e Qarkut, gjegjësisht Gjykatat Themelore:<sup>43</sup>

Viti	Nr. i lëndëve të shkurorëzimit të martesës	Nr. i përgjithshëm i lëndëve të shkurorëzimit të martesës gjatë viteve 2009-2013
2009	1555	= 6846
2010	1453	
2011	1469	
2012	1329	
2013	1040	

Sipas statistikave të marra nga Gjykata Themelore e Tetovës, numëri i lëndëve të shkurorëzimit paraqet një rritje. Të dhënat e viteve të fundit sa i përket numrit të lëndëve të shkurorëzimit në Gjyaktën Themelore të Tetovës:<sup>44</sup>

Viti	Nr. i lëndëve të shkurorëzimit të martesës	Nr. i përgjithshëm i lëndëve të shkurorëzimit gjatë viteve 2012-2016
2012	325	= 1770
2013	330	
2014	356	
2015	368	
2016	394	

<sup>43</sup> Gashi Kushtrim, Shkaqet dhe Pasojat e Shkurorëzimit në Kosovë, 2015, <https://telegrafi.com/shkaqet-dhe-pasojat-e-shkurorëzimit-ne-kosove/>

<sup>44</sup> Satatistika për numrin e lëndëve të shkurorëzimit nga Gjykata Themelore e Tetovës, 15.11.2017



## 1.2 Pasojat që rrjedhin nga shkurorëzimi i martesës

Mbarimi i martesës për shkak të zgjidhjes së saj shënon fundin e marrëdhënies martesore për bashkëshortët. Vendimi i gjykatës ka karakter konstitutiv, cka do të thotë që krijon një situatë të re juridike në të ardhmen. Shuhen të drejtat dhe detyrimet që buronin nga martesa dhe lindin të drejta dhe detyrime të reja, një pjesë e të cilave ruajnë në vetvete gjurmët e martesës së mbaruar.<sup>45</sup>

Pasojat e zgjidhjes së martesës për ish-bashkëshortët ndahen në dy kategori të mëdha: në pasoja me karakter personal dhe në pasoja me karakter material. Një ndarje e tillë është rrjedhojë e drejtëpërdrejtë e faktit se bashkëshortët kanë qenë të martuar, se midis tyre kanë vepruar disa të drejta dhe detyrime të caktuara, një pjesë e të cilave, në varësi të karakteri që kanë pasur gjatë martesës, vazhdojnë të ekzistojnë, veçse të transformuara në formë.<sup>46</sup> Pasojat e karakterit material janë: pasojat lidhur me të drejtën e trashëgimit, detyrimi për ushqim ndërmjet bashkëshortëve, kontributi kompensues, e drejta e përdorimit të banesës familjare dhe mbarimi i regjimit martesor pasuror. Pasojat me karakter personal janë statusi i bashkëshortëve, mbiemri, ndarja e fëmijëve të përbashkët, etj.<sup>47</sup> Autori është bazuar në Kodin për Familjen të Shqipërisë.

Me rastin e zgjidhjes së martesës rrjedhin disa pasoja juridike ndaj ish-bashkëshortit të cilat janë në lidhje me: gjendjen statusore, mbiemrin, pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, trashëgimin, banimin, ushqimin e bashkëshortit të pasiguruar, dhuratat, dëmshpërblimin dhe shpenzimet gjyqësore.<sup>48</sup> Autori është bazuar në Ligjin për Familje të Kosovës.

- ❖ **Gjendja statusore-** Gjendja statusore e bashkëshortëve të martuar kalon në gjendjen statusore të bashkëshortëve të shkurorëzuar.
- ❖ **Mbiemri-** Pas shkurorëzimit të martesës bashkëshortja respektivisht gruaja ndërton mbiemrin e saj të cilin e ka fituar përgjatë lidhjes martesore, si dhe rivendos mbiemrin e sajë të mëparshëm.
- ❖ **Pjestimi i pasurisë së përbashkët-** Pjestimi i pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit kalon në pasurinë e veçantë të ish-bashkëshortëve, gjykata gjatë

---

<sup>45</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.429

<sup>46</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.430

<sup>47</sup> Po aty, fq.431,432

<sup>48</sup> Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, fq.177

ndarjes së pasurisë së përbashkët konsideron kontributin e tyre në bazë të rrethanave duke u bazuar në ligj.

- ❖ **Trashëgimia**- Më pushimin e martesës pushon edhe e drejta e bashkëshortit për ta trashëguar bashkëshortin tjetër, respektivisht pushon trashëgimi ligjor, përveç trashëgimit në bazë të testamentit.
- ❖ **Banimi**- Me shkurorezimin e martesës bashkëshortët duhet që të vendosin për vendbanimin e tyre pas ndarjes, duke e bërë këtë me anë të marrëveshjes, mirëpor, në rast mosmarrëveshje të njëjtën do ta përcakton gjykata në bazë të rrethanave, bazuar në ligj.
- ❖ **Detyrimi për ushqim**- Njëri nga bashkëshortët ka të drejtë në kërkesë ndaj bashkëshortit tjetër në detyrimin në ushqim, nëse përfituesi nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë apo ka në përkujdesje fëmijët e përbashkët, si dhe bashkëshorti i cili është i detyruar të japë këtë detyrim duhet që të ketë mundësi për të përmbushur detyrimin për ushqim.
- ❖ **Dhuratat**- Me shkurorezimin e martesës, shtrohet çështja e dhuratave të cilat bashkëshortët i kanë dhuruar gjatë martesës bashkëshortore, të dhuratave me vlerë të madhe. Si p.sh., unazat e çmueshme, ari në forma të ndryshme, xhevahiret, ose ndonjë dhuratë me vlerë më të madhe (veturë, banesë etj).<sup>49</sup>

Si pasojë nga shkurorezimi i martesës paraqiten edhe fëmijët e përbashkët të ish-bashkëshortëve. Si pasojë për fëmijët paraqitet: gjendja statusore e fëmijës dhe përkujdesi për fëmijët.<sup>50</sup>

---

<sup>49</sup> Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, fq.181

<sup>50</sup> Po aty, fq. 182

## **KREU I KATËRT**

### **1. Pozita juridike pasurore pas shkuorëzimit të martesës në sistemet juridike bashkëkohore**

Koncepti i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në sistemet juridike bashkëkohore është vendosur me idenë e sigurimit të barazisë dhe solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve. Ky regjim, në konceptin e tij parimor, synon të pamundësojë shfrytëzimin ekonomik të bashkëshortit i cili nuk ushtron veprimtari me efekte financiare, e që si rezultat i mungesës së emancipimit dhe pregaditjes së nevojshme profesionale, në realitetin tonë shoqëror, edhe sot e kësaj dite më së shpeshti është gruaja.<sup>51</sup> Regjimi i pasurisë së përbashkët nuk i përgjigjet aktualitetit bashkëkohor edhe për arsye të rritjes së numrit të shkurorëzimeve, si pasojë e të cilave shtohet numri i kontesteve pasurore të bashkëshortëve, të cilat gjykatat nuk janë në gjendje që t'i zgjidhin.<sup>52</sup>

Ekzistojnë dy llojë regjimesh për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve: regjimi pasuror ligjor si dhe regjimi pasuror i kontraktuar.

#### **1.2 Regjimi pasuror ligjor**

Në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë pozita juridiko-pasurore e bashkëshortëve në martesë është rregulluar me dispozita imperative. Këto dispozita kanë proklamuar regjimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve si regjim pasuror ligjor.<sup>53</sup> Këta dispozita të regjimit pasuror ligjor, detyrojnë bashkëshortët që përgjatë rregullimit të marrëdhënieve pasurore të tyre të përmbahen në rregulla ligjore. Regjimi pasuror ligjor i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Ligjin për Pronësi dhe të drejta tjera sendore (nenet 66-80) të cilat përfshijnë: pasurinë e veçantë të bashkëshortëve si dhe pasurinë e përbashkët të tyre, administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët si dhe ndarjen e saj.

Në regjimin pasuror ligjor, bashkëshortët detyrohen në rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, që nënkupton se bashkëshortët nuk kanë mundësi për një alternativë tjetër për

---

<sup>51</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualëve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.10

<sup>52</sup> Po aty fq.10

<sup>53</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.2

rregullimin e marrëdhënieve të pasurisë së përbashkët të tyre, e cila do të ndikon edhe në ndarjen e pasurisë së përbashkët, ku ndarja e pasurisë së përbashkët nga gjykata do të bëhet duke u bazuar në ligj (LPDTS).

## 1.2 Regjimi pasuror i kontraktuar

Ekzistojnë vende të cilat përveç regjimit pasuror ligjor, për rregullimin e marrëdhënieve të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, si alternativë kanë edhe regjimin pasuror të kontraktuar. Për shembull në Republikën e Shqipërisë si regjim për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, bashkëshortët kanë mundësi të zgjedhin edhe regjimin pasuror të kontraktuar.

Kontrata e martesës, që përherë të parë zë vend në Kodin e Familjes së Shqipërisë (2003), s'është gjë tjetër veçse një akt juridik me anë të së cilit bashkëshortët e ardhshëm fiksojnë regjimin e tyre martesor, në parim, për të gjithë kohëzgjatjen e martesës.<sup>54</sup> Nëpërmjet kontratës së martesës bashkëshortët organizojnë mjetet ekonomike të familjes së tyre, përcaktojnë midis pasurive që ato do të jenë në pronësi tërësore të njërit prej tyre dhe atyre që do të jenë të përbashkëta.<sup>55</sup>

Në krahasim me regjimin pasuror ligjor, regjimi pasuror i kontraktuar, bashkëshortët mund të parashikojnë edhe kushte të cilat nuk janë paraparë me ligj. Bashkëshortët me marrëveshje do të përcaktojnë pjesët e tyre, si edhe administrimin dhe disponimin me pasurinë e përbashkët të tyre, ku në rast të shkurorëzimit, palët janë të informuar për pjesët e tyre.

Pavlefshmëria e kontratës së martesës nuk sjell pasoja mbi martesën. Në këtë rast bashkëshortët i nënshtrohen regjimit martesor ligjor. Kontrata martesore është e shkruar dhe bëhet para noterit.<sup>56</sup>

---

<sup>54</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.320

<sup>55</sup> Po aty, fq.321

<sup>56</sup> Po aty, fq.321

## KREU I PESTË

### 1. Pozita juridiko-pasurore e gruas pas shkurorëzimit të martesës në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në Republikën e Maqedonisë, ashtu sikundër edhe në njësitë e tjera federative, gjatë ish sistemit socialist, nuk kanë gëzuar vëmendjen e mjaftueshme të ligdhënësit, ato janë rregulluar me dispozita familjare imperative, të përmbajtura në Ligjin për martesën 1946 dhe pasardhësin e tij Ligjin për martesën 1973.<sup>57</sup> Këto ligje kanë proklamuar regjimin ligjor të pasurisë së përbashkët dhe pasurisë së veçantë të bashkëshortëve, si regjim të vetëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve. Një zgjidhje e këtillë ligjore ka qenë e frymëzuar nga ideja se regjimi i pasurisë së përbashkët (si e drejtë e pronësisë së dy e më tepër personave mbi një send të vetëm, ku pjeset e tyre nuk janë përcaktuar as idealisht e as realisht) siguron barazinë në mes bashkëshortëve dhe eviton varshmërinë ekonomike ndërmjet tyre.<sup>58</sup>

Republika e Maqedonisë ka pësuar ndryshime të mëdha pas pavarësimit të saj në vitin 1991. Ndryshimet ishin të aspekteve të ndryshme, si ato juridike, ekonomike, politike, si dhe ato tregtare. Duke pasur parasysh, se liria e kontraktimit paraqet njërin prej parimeve themelore të ekonomisë bashkëkohore të tregut, ky parim pritej të refleктоhej edhe në marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, edhe atë, në kuptim të krijimit të një hapësire më të gjërë të lirisë së kontraktimit të marrëdhënieve pasurore të tyre. Megjithatë, kjo aspiratë nuk u realizua as nga Ligji i familjes (1992), i cili edhe pse u soll një vit pas pavarësimit, nuk solli ndonjë risi, ashtuqë edhe më tutje bashkëshortët mbetën të nënshtruar brenda kornizave të regjimit pasuror ligjor.<sup>59</sup>

---

<sup>57</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualëve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.3

<sup>58</sup> Po aty, fq.3

<sup>59</sup> Po aty, fq.3

## **1.1 Regjimi pasuror i bashkëshortëve në dispozitat e Ligjit për pronësi dhe të drejta të tjera sendore (2001)**

Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve rregullohen me Ligjin për pronësi dhe të drejta tjera sendore të vitit 2001, për dallim nga Republika e Shqipërisë e cila i rregullon këto marrëdhënie me Kodin për Familje të Shqipërisë, si dhe Republika e Kosovës me Ligjin për Familje të Kosovës. Rregullimi i këtyre marrëdhënieve me një ligj pronësor në aspektin formal aludonte në faktin se ligdhënësi do të trajtonte marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në mënyrë të njëjtë me marrëdhëniet pasurore që krijohen ndërmjet subjekteve të së drejtës civile në përgjithësi, respektivisht, do të krijonte hapësirën e nevojshme për autonomi të vullnetit të bashkëshortëve, sa i përket kontraktimit të regjimit të pasurisë së tyre në martesë.<sup>60</sup> Megjithatë LPDTS lejonë bashkëshortët që vetëm në bazë të regjimit ligjor të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore të cilat janë të përfshira në nenet 66-80 në Ligjin për Pronësi dhe të drejta tjera sendore, ndërsa regjimin e kontraktuar nuk e përfshinë në ndonjë nen të këtij ligji. LPDTS për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në nenet 66-80 përfshinë pasurinë e veçantë të bashkëshortëve, si dhe pasurinë e përbashkët të tyre. Ligji për Pronësi dhe të drejta sendore i RM-së neni 66 parasheh: "Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë e përbashkët dhe e ndarë."

LPDTS për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, parasheh dispozita të caktuara të cilat rregullojnë: përcaktimin e pronësisë së veçantë të bashkëshortëve, përcaktimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, rregullimin e administrimit dhe disponimit me pasurinë e përbashkët, ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë martesës dhe pas pushimit të martesës, si dhe detyrimet e bashkëshortëve.

---

<sup>60</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualeve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.4

### 1.1.1 Pronësia e përbashkët dhe e veçantë e bashkëshortëve sipas LPDTS

Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë e përbashkët dhe e ndarë. Pasuria të cilën bashkëshortët e fitojnë gjatë kohëzgjatjes së martesës paraqet pronësi të tyre të përbashkët. Pasurinë të cilën njëri prej bashkëshortëve e ka pasur në kohën e lidhjes së martesës paraqet pasurinë e tij të veçantë. Si pasuri e veçantë do të llogariten edhe pasuria edhe e drejta mbi pasurinë, të cilën bashkëshorti do të fitojë në bazë të trashëgimisë, legut dhe dhuratës si dhe sendet e fituara gjatë martesës, por që shërbejnë për kënaqjen e kërkesave personale të njërit prej bashkëshortëve, nëse nuk paraqesin vlerë në disproporcion të madh në krahasim me vlerën e tërë pronësisë së përbashkët.<sup>61</sup>

Ligdhënësi në LPDTS (nenet 66-80) nuk përmend fjalën “punë” si kontribut për fitimin e pasurisë së përbashkët, megjithëse gjykata në vendimet gjyqësore në masë të madhe përdor punën si fakt i fitimit të pronësisë së përbashkët gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët. Gjatë zgjidhjes së kontesteve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, gjykata merr parasysh punën, si bazë juridike për fitimin e pasurisë së përbashkët, edhe atë, të gjitha llojet e punës që mund të vijnë në shprehje, qofshin ato punë që kanë efekt të drejtëpërdrejtë financiar, apo edhe punë që kontribuojnë në rruajtjen e fitimit.<sup>62</sup>

Si kusht për ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në LPDTS paraqitet “martesa”. Periudha prej lidhjes së martesës deri me pushimin e saj konsiderohet periudha gjatë të cilës bashkëshortët mund të kontribuojnë në krijimin e pasurisë së përbashkët. Me pushimin e martesës krijohet pasuria e veçantë e bashkëshortëve.

Pasuri e veçantë e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e çdonjerit nga bashkëshortët, e cila nuk i është nënshtruar regjimit juridik të pasurisë së përbashkët.<sup>63</sup>

---

<sup>61</sup> Neni 66-68, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>62</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.4

<sup>63</sup> Po aty, fq.6

### **1.1.2 Administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët dhe pasurinë e veçantë të bashkëshortëve**

Administrimi i pronës së përbashkët nënkupton marrjen e atyre masave apo veprimeve të zakonshme për përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, siç mund të jetë: pagesa e qirasë, pagesa e tatimit, mbledhja e frutave, etj. Ndërsa disponimi përfshinë veprimet me të cilat bashkëshortët pronën e tyre e tjetërsojnë apo e ngarkojnë, p.sh: shitja e shtëpisë, vënia e hipotekës mbi pasurinë e përbashkët (tokën, shtëpinë, banesën) këmbimin, dhurimin, shkatërimin e sendit-disponimin faktik, etj, si autorizime më të larta që mund ti ketë njeriu mbi sendin.<sup>64</sup>

Bashkëshortët në formë të shkruar mund të merren vesh që administrimin dhe disponimin me pasurinë e përbashkët ose me një pjesë të saj ta kryen njëri prej tyre. Marrëveshja mund t'i referohet të gjitha punëve të administrimit dhe disponimit ose vetëm administrimit të rregullt ose vetëm punëve të caktuara saktë.<sup>65</sup>

Bashkëshortët me kontratë rregullojnë mënyrën dhe masën e administrimit dhe disponimit me sendet në pronësi të përbashkët. Këto kontrata nuk lidhen njëherë e përgjithmonë, prandaj bashkëshortët varësisht nga rethanat, kanë mundësi që në çdo kohë të kontraktojnë diçka tjetër.<sup>66</sup>

Bashkëshortët mund që të merren vesh për administrimin e pronës së përbashkët të tyre, që njëri nga bashkëshortët të administrojë me atë pasuri. Në rast se bashkëshortët nuk merren vesh për administrimin e pasurisë së përbashkët atëherë gjykata në procedurë jashtëkontestimore do të përcaktojë masa për administrimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Këtë LPDTS e përcakton në nenin 73 ku përcakton saktësisht se: "Nëse me administrimin me pasurinë e përbashkët ose për punë të caktuara lidhur me administrimin, bashkëshortët nuk mund të merren vesh, ndërkohë që asnjëri prej tyre nuk kërkon vërtetimin e pjesëve në pronësinë e përbashkët, gjykata në procedurën jokontestimore ka mundësi që me propozim të njërit bashkëshort të përcaktojë masat e duhura që kanë të bëjnë me administrimin."

---

<sup>65</sup> Neni 71, parag.1-2, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>66</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.7



Këto të drejta të bashkëshortëve lidhur me administrimin dhe disponimin me pronësinë e përbashkët, janë pasojë e domosdoshme e natyrës juridike të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, mënyrës së fitimit të saj, dhe parimit të barabarsisë dhe solidaritetit ndërmjet tyre.<sup>67</sup>

Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (2001) nuk ka paraparë ndonjë kufizim sa i përket administrimit dhe disponimit me pasurinë e veçantë. Mirëpo, edhe pse ligjdhënësi drejtëpërdrejtë nuk përmend nevojën e kufizimit të administrimit dhe disponimit të pavarur me pasurinë e veçantë, praktika gjyqësore duhet të sugjerojë, që në rast se mjetet nga pasuria e përbashkët nuk mjaftojnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta jetësore, bashkëshortët duhet që me mjete nga pasuria e tyre e veçantë të ndihmojnë në plotësimin e nevojave të përbashkëta.<sup>68</sup>

Alinea e dytë e nenit 70 të LPDTS thekson “Bashkëshorti nuk ka të drejtë që me pjesën e vetë në pronësi të përbashkët, të disponojë, as ta ngarkojë, me punë juridike ndërmjet të gjallëve”, dispozita “ndërmjet të gjallëve”, nënkupton se mundësohet disponimi i pasurisë në rast “*mortis causa*” pra vdekjeje, me testament por vetëm sa i përket pjesës ideale të vet.<sup>69</sup> Lidhur me këtë në praktikën gjyqësore është pranuar qëndrimi se bashkëshorti ka të drejtë të lidhë kontratë për mbajtjen e përhjetshme lidhur me pjesën e vet në pronësi të përbashkët.<sup>70</sup> Edhe pse kontrata për mbajtjen e përhjetshme paraqet punë juridike mes të gjallëve, duke pasur parasysh efektet e bartjes të së drejtës së pronësisë mbi sendet e përfshira në të paraqiten pas vdekjes, është krijuar mundësia e disponimit të tillë, ngjajshëm sikurse edhe te disponimi testamentar.<sup>71</sup>

Kontrata për autorizim, me të cilën autorizohet bashkëshorti tjetër të disponojë me paluajtshmëri, respektivisht autorizohet që të lidhë kontratë me të cilën bartet e drejta e pronësisë, apo e drejta e shfrytëzimit mbi paluajtshmëri si dhe kontratën me të cilën krijohet e drejta e hipotekës mbi paluajtshmërinë e pronës së përbashkët, duhet të kenë formën me shkrim.<sup>72</sup>

---

<sup>67</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.6

<sup>68</sup> Po aty, fq.8

<sup>69</sup> Cavdar Kiril, Komentar na Zakonot za semejtvo na RM, Skopje, 1980, fq.343

<sup>70</sup> Neni 1029, Zakon za obligacionite odnosi “Sluzben Vesnik” na RM, br.53/2001

<sup>71</sup> Cavdar Kiril, Komentar na Zakonot za semejtvo, Skopje, 1980, fq.343

<sup>72</sup> Neni 9, Zakon za promet so zemjishta i zgradi, “Sluzben Vesnik” na RM, br.4/1993

Ligdhënësi e përkufizon administrimin me shprehjet: administrim i rregullt, disponim në kuadër të administrimit të rregullt dhe disponim të jashtzakonshëm.

Me **administrim të rregullt** nënkupton mirëmbajtjen e sendit, pagesat e taksave, pagesat e rrymës, nxemjes, mbledhjen e frytave, etj., si dhe të gjitha veprimet faktike dhe juridike të njërit bashkëshort lidhur me sendin në pronësi të përbashkët.<sup>73</sup> Kur bëhet fjalë për ndërmarrjen e punëve që paraqesin administrim të rregullt të sendeve në pronësi të përbashkët (p.sh. punimi i tokës), ato mund t'i kryejë edhe vetëm njëri nga bashkëshortët. Me këtë rast vlen supozimi ligjor, se egziston pëlqimi ndërmjet bashkëshortëve.<sup>74</sup>

Me **disponim të sendit brenda kufijve të administrimit të rregullt**, nënkuptohet fakti se bashkëshorti që administron me pronësinë e përbashkët ka edhe të drejtën që të tjetërsojë sendet e konsumueshme, frutat etj (sendet aksesore), por, nuk ka të drejtë të tjetërsojë sendin kryesor. Nëse bashkëshortët nuk kanë kontraktuar diçka tjetër, administrimi i sendit do të përfshijë edhe disponimin e sendit brenda kufijve të administrimit të rregullt.<sup>75</sup> Një shembull për këtë është kur bashkëshorti ka të drejtë të shesë frutat, por nuk ka mundësi të shesë edhe trungun.

Me disponim të jashtzakonshëm të pronës së përbashkët, nënkuptohet ndërmarrja e punëve juridike me të cilat tjetërsohet ose ngarkohen sendet kryesore që përbëjnë pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, siç mund të jetë: shitja e gjithë sendit, dhurimi, këmbimi, dhënia me qera, krijimi i të drejtës së pengut mbi sendet e luajtshme me vlerë, krijimi i hipotekës, bashkëshorti duhet medoemos të sigurojë pëlqimin e bashkëshortit tjetër, të shprehur në formën, e cila kërkohet për punën juridike përkatëse që do të lidhet.<sup>76</sup>

---

<sup>74</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.7

<sup>75</sup> Po aty, fq.7

<sup>76</sup> Neni 72, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

## KREU I GJASHTË

### 1. Ndarja e pronës së përbashkët të bashkëshortëve

Duke i njohur bashkëshortët si pronarë të barabartë të sendeve në pronësi të përbashkët, ligjdhënësi pretendon të jetësojë idenë e barazisë dhe solidaritetit ndërmjet bashkëshortëve. Megjithatë, për të evituar defektet eventuale që mund të shkaktojë ky regjim (kur kemi parasysh faktin, se bashkëshortët nuk kanë aftësi të njëjta, dhe shpesh mund të ndodh që bashkëshorti më i aftë edhe të dëmtohet nga rregullat e regjimit të pronësisë së përbashkët), ligjdhënësi ka kombinuar regjimin e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve me regjimin e pronësisë së veçantë, me të cilin siguron pronësinë individuale, të cilën, bashkëshortët e sjellin në martesë ose e fitojnë gjatë kohëzgjatjes së martesës, por, sipas disa bazave të tjera juridike (dhurata, legu, testamenti) e jo si rezultat i punës së tyre.<sup>77</sup> Prona e përbashkët e bashkëshortëve është kategori e ndryshueshme, si dhe ndarja e saj është paraparë me ligj. Me anë të ndarjes së pasurisë së përbashkët pasuria e përbashkët e bashkëshortëve shëndërohet në pasuri të veçantë të tyre.

Ndarja e pasurisë së përbashkët është e rregulluar me legjislacion pozitiv si në Republikën e Maqedonisë me LPDTS, në Kosovë me Ligjin për Familje dhe në Shqipëri me Kodin për Familje, ndarja e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bazohet në parimin e barazisë së bashkëshortëve. Gjithashtu në ligjet e Republikës së Maqedonisë si dhe në Republikën e Kosovës, ligjvënësi parashikon se gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve merret parasyshë kontributi i bashkëshortëve që kanë dhënë gjatë krijimit të pasurisë së përbashkët deri në ndarjen e sajë.

Siç kemi parashtruar më lartë, se prona ndryshon, andaj Ligjin për Pronësi dhe të drejta tjera sendore në Republikën e Maqedonisë atë e parasheh në nenin 74 se “Gjatë martesës dhe pas mbarimit të saj, bashkëshortët mund me marrëveshje të ndajnë pronën e tyre të përbashkët”. Që nënkupton se prona e përbashkët e bashkëshortëve mund të pushojë gjatë martesës si dhe pas pushimit apo mbarimit të martesës. Sipas këtij ligji mund të vërejmë se si është caktuar koha në të cilën bashkëshortët mund që të kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët, si dhe e drejta e

---

<sup>77</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.2,3

subjekteve, konkretisht e drejta e bashkëshortëve që ta kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët. Ndarja e pasurisë së përbashkët përfshinë atë pasuri të cilën bashkëshortët e kanë fituar gjatë martesës deri në momentin e ndarjes së asaj pasurie.

Mënyra e fitimit të pasurisë së përbashkët (me punë gjatë martesës), determinon edhe mënyrën e ndarjes së saj dhe kriteret që me këtë rast merren parasysh. Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, ka promovuar sistemin e ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta, por, këtij qëndrimi nuk ka mundur t'i qëndrojë besnik deri në fund, prandaj, sistemi i pjesëve të barabarta në praktikë është kombinuar me sistemin e ndarjes së pasurisë së përbashkët sipas kontributit.<sup>78</sup> Supozimi ligjor se bashkëshortët janë të barabartë në ndarjen e pasurisë së përbashkët neni 75, al.2, në Ligjin për Pronësi dhe të drejta tjera sendore të Republikës së Maqedonisë, ku parasheh: "Gjatë vërtetimit të pjesëve të bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët, gjykata niset nga fakti se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta", supozim ligjor i cili shpesh paraqitet si kontestues. Prandaj, mundësia e padrejtësisë eventuale që mund të sjellë ndarja e pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta është korigjuar me nenin 75, al.3 të ligjit në fjalë, ku është paraparë mundësia që me kërkesë të bashkëshortit, gjykata në procedurë gjyqësore t'i përcaktojë pjesë më të madhe, bashkëshortit, i cili arrin të argumentojë se kontributi i tij në krijimin e pasurisë së përbashkët është dukshëm më i madh.<sup>79</sup>

Nëse bashkëshorti vdes ose shpallet si i vdekur, nëse bashkëshortët shkurorezohen, apo nëse ata e anulojnë martesën<sup>80</sup>, atëherë prona e përbashkët e tyre pushon me pushimin e martesës.<sup>81</sup>

Bashkëshortët edhe gjatë kohëzgjatjes së martesës kanë të drejtë të bëjnë ndarjen e pronësisë së përbashkët.<sup>82</sup> Kjo ndarje gjatë martesës bëhet me marrëveshje, që nënkupton vullnetin e lirë të palëve të cilët do të vendosin se cilat sende do të jenë objekt pjestimi dhe cilat jo. Mirpo në rast se ata nuk mund ta arrijnë ndarjen e pasurisë së përbashkët me anë të marrëveshjes, këta i drejtohen gjykatës për një zgjidhje efikase.

---

<sup>78</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualeve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.9

<sup>79</sup> Po aty, fq.9

<sup>80</sup> Neni 35, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim Ligji për Familje i RM-së, "Gazeta Zyrtare" e RM-së

<sup>81</sup> Neni 39,40,41, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim Ligji për Familje i RM-së

<sup>82</sup> Neni 74, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

Ndryshe nga Ligji i Familjes i Kosovës dhe LPDTS të Maqedonisë, Kodi i Familjes i Shqipërisë nuk e lejon pjestimin e pasurisë së përbashkët në qoftë se vazhdon martesë, të cilën e parasheh në nenin 97: “Pjestimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshje të bashkëshortëve.” Pjestimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohet në gjykatë në rast paaftësie dhe administrimit të keq të njërit prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë prej tij vë në rezik interesat e bashkëshortit tjetër ose familjes, ose kur njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjestim faktik i pasurisë në bashkësi.<sup>83</sup>

Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të bëhet gjatë ekzistimit të lidhjes martesore, megjithëse më shumë ndodh që bashkëshortët pasurinë e tyre të përbashkët t’a ndajnë gjatë shkurorëzimit të martesës. Kështuqë, pas çdo shkurorëzimi të martesës marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve bëhen objekt i procedurave të gjata gjyqësore. Rritja e numrit të shkurorëzimeve, ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të procedurave gjyqësore që zhvillohen lidhur me ndarjen e pronësisë së përbashkët. Të dhënat statistikore që flasin për numrin e shkurorëzimeve tregojnë se, përderisa nga viti në vit numri i kurorëzimeve, me lëvizje të vogla, është i njëjtë, numri i shkurorëzimeve thuhet të jetë dyfishuar. Kështu në vitin 1950 në RM-së janë lidhur gjithsej 14123 martesë, ndërsa janë shkurorëzuar 938 prej tyre, ndërsa në vitin 2004 janë lidhur 14073 martesë (50 martesë më pak se në vitin 1950), dhe janë shkurorëzuar 1645 prej tyre (707 shkurorëzime më tepër se në vitin 1950). Ndërkohë që, të dhënat më të reja statistikore tregojnë se numri martesave të lidhura në vitin 2011 është 14736, respektivisht për 4.1% më i lartë në krahasim me vitin 2010, ndërkohë që numri i martesave të shkurorëzuara është 1753, respektivisht 1.9% më i lartë në krahasim me vitin 2010.<sup>84</sup>

Sipas KFSH-së, pjestimin e pasurisë në bashkësi e parasheh neni 103 ku parasheh se “pjestimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga pasuria e aktivitetit dhe pasivitetit të saj.” Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose ndaj të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve.<sup>85</sup> Regjimi i pasurive të ndara udhëhiqet nga parimi “secili për vete”, me përjashtim të rasteve kur

---

<sup>83</sup> Neni 98, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

<sup>84</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.4

<sup>85</sup> Neni 103, par 2, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

bashkëshortët blejnë një pasuri të pandashme dhe parimi shndërrohet në “të dy për të dy”.<sup>86</sup> Një shembull për këtë mund të marrim rastin e blerjes së një shtëpie familjare nga të dy bashkëshortët.

Supozimi ligjor i ndarjes së pasurisë së përbashkët në pjesë të barabarta, përveç nga bashkëshorti, mund të kontestohet edhe nga trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të shpallur për të vdekur. Kështu, sipas një vendimi të gjykatës, e paditura (trashëgimtarja nga martesë e parë e trashëgimlënësit), ka arritur të rëzojë supozimin ligjor të ndarjes së pasurisë në pjesë të barabarta dhe ta bindë gjykatën se paditësja (bashkëshortja e dytë e trashëgimlënësit) nuk është pronare e ½ pjesë ideale të shtëpisë së ndërtuar gjatë martesës. Në arsyetimin e saj gjykata precizon se: “që një pasuri të konsiderohet si pasuri e përbashkët, nuk mjafton që ajo të jetë fituar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, por, kërkohet që ajo të jetë fituar me kontribut të përbashkët të bashkëshortëve”. Në rastin konkret, trashëgimlënësi gjatë tërë periudhës së bashkësisë martesore ka qenë drejtor i postës dhe ka pasur të ardhura pesë herë më të mëdha se paditësja, e cila ka punuar vetëm gjashtë vite dhe realisht nuk ka mundur të kontribojë në kurrfarë mënyre në fitimin e kësaj pasurie.<sup>87</sup>

Sipas Kodit të Familjes së Shqipërisë, në rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët bëhen edhe kompensimet e nevojshme të bashkëshortit tjetër, gjithashtu parashikon rastet e veçanta të kompensimit pas mbarimit të bashkësisë dhe në favor të saj. Në këtë rast, bashkësia mund të përfitojë kompensim për të ardhurat dhe pasuritë që bashkëshorti ka neglizhuar të marrë ose për ato që ai ka shpenzuar në keqbesim gjatë kohëzgjatjes së martesës.<sup>88</sup> Kompensim të bashkësisë nga njëri bashkëshort kemi edhe në rastet kur:

- Detyrimi vetjak i bashkëshortit është shlyer nga bashkësia;
- Detyrimi është kontraktuar në interesin vetjak të njërit bashkëshort dhe është shlyer nga pasuria në bashkësi;

---

<sup>86</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.359

<sup>87</sup> Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualëve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014, fq.9

<sup>88</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.353

- Janë paguar nga bashkësia gjoba ose dëmshpërblime për shkak të një dënimi penal ose administrative të njërit bashkëshort.<sup>89</sup>

Shpesh paraqiten raste gjatë ekzistimit të martesës së bashkëshortëve, ku pasuria e veçantë e njërit nga bashkëshortët të kalojë në pasuri të përbashkët dhe anasjelltas. Do të sjellim këtu, një shembull nga praktika gjyqësore, i cili flet për vendimin e gjykatës mbi një situatë të tillë. Sipas vendimit në fjalë, gjykata nuk i ka njohur të drejtën e pronësisë bashkëshortit, i cili kërkonte që t'i njihet drejta e pronësisë mbi ½ pjesë ideale të ndërtesës, e cila ishte në pronësi të veçantë të bashkëshortit tjetër, por ishte rinovuar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, duke shfrytëzuar për këtë qëllim mjetet nga pronësia e përbashkët e bashkëshortëve. Në fakt, gjykata bashkëshortit paditës nuk i ka njohur të drejtë të karakterit juridiko-sendor ndaj ndërtesës kontestuese, pra, nuk i ka njohur të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën, por vetëm të drejtën e kërkesës obligative në të holla, në emër të kontributit që ka dhënë për rinovimin e ndërtesës.<sup>90</sup>

Ndarja e pronësisë së përbashkët ka domethënien e likuidimit juridik të regjimit imperative të pronësisë së përbashkët dhe vendosjen e regjimit të pronësisë së veçantë të bashkëshortëve.<sup>91</sup>

Ndarja gjyqësore e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve nuk mund të bëhet në të njëjtën procedurë me shkurorëzimin e martesës, përveç rastit, kur gjatë zhvillimit të procedurës bashkëshortët arrijnë ujdj gjyqësore dhe kjo regjistrohet në procesverbal.<sup>92</sup>

---

<sup>89</sup> Po aty, fq.354

<sup>90</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.3

<sup>91</sup> Neni 74, par 2, Zakon za sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>92</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.4,5

### **1.1 Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve me marrëveshje**

Ndarjen e pasurisë së përbashkët bashkëshortët kanë të drejtë që të realizojnë me anë të marrëveshjes së tyre, mirëpor në rast mosmarrëveshje dhe në rast konflikti, bashkëshortët do t'i drejtohen gjykatës kompetente për të zgjidhur konfliktin në mes tyre si dhe të bëjë ndarjen më efikase të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Mënyra e ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve me marrëveshje, është mënyra paqësore e shrehjes së vullnetit të lirë të tyre, ku ata vetë vendosin se cilat sende do të jenë objekt pjestimi e cilat jo. Ajo që është më e rëndësishme është se bashkëshortët me ndarjen e pasurisë së përbashkët të tyre e shëndrojnë atë në pasuri të veçantë, mirëpo pas ndarjes së pasurisë të përbashkët në qoftë se martesë e bashkëshortëve vazhdon, atëherë ajo çka themelohet apo krijohet pas, do të konsiderohet pasuri e re e përbashkët e bashkëshortëve. Ndërsa me pushimin e martesës kemi vetëm krijim të pronësisë së veçantë të bashkëshortëve.

Ndarja me marrëveshje në Ligjin për pronësi dhe të drejta sendore të Republikës së Maqedonisë parashihet në nenin 74, ku thuhet: "Gjatë kohëzgjatjes së martesës dhe pas pushimit të saj bashkëshortët me marrëveshje mund të ndajnë pronësinë e përbashkët". Nga kjo dispozitë nënkuptojmë se bashkëshortët kanë të drejtë në çdo kohë të vendosin për pjestimin e pasurisë së tyre, gjatë martesës apo pasi ajo të mbarojë. Mënyra e tillë e ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve është mënyra më e shpeshtë e rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve në praktikë.

Njëri nga bashkëshortët ka mundësi që në pronën e tij të veçantë të përfshijë sende të cilat nuk mund të ndahen fizikisht nga prona e përbashkët, ashtu që bashkëshorti tjetër i jep kompenzim të caktuar në të holla për pjesën e tij në pronësi të përbashkët.<sup>93</sup>

Bashkëshortët për pjesën të cilën ata merren vesh e ndajnë me anë të marrëveshjes në mënyrë paqësore, ndërsa për pjesën tjetër për të cilën nuk merren vesh, ata i drejtohen gjykatës.

---

<sup>93</sup> Neni 52, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001




## 1.2 Ndarja gjyqësore e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve

Ndarja gjyqësore paraqitet si mënyrë sekundare e ndarjes së pronës së përbashkët të bashkëshortëve, atëherë kur ndarja me marrëveshje nuk realizohet apo dështon. Njëjtë sikur ndarja me marrëveshje edhe ndarja gjyqësore mund të bëhet në çdo kohë, gjatë martesës apo pas pushimit të saj. Kjo është e drejtë subjektivo-sendore absolute dhe si e tillë nuk mund të parashkruhet.<sup>94</sup>

Pjesët e bashkëshortëve në pronësinë e përbashkët konsiderohen të barabarta, kjo duke u bazuar në legjislacion, neni 75 i RM-së, LPDTS paragrafi 2, “Gjatë përcatimit të pjesëve të bashkëshortëve martesor, gjyqi bazohet në faktin se prona e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta”. Parimin e barazisë së bashkëshortëve e parasheh edhe Kodi i Familjes së Shqipërisë në nenin 103, gjithashtu edhe ai i Kosovës në LFK sipas nënit 52 “Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij.”

Ndarja gjyqësore e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve bëhet në procedurë jokontestimore<sup>95</sup> dhe në procedurë kontestimore<sup>96</sup>.



<sup>94</sup> Nenin 63, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>95</sup> Neni. 213-227, Ligji për procedurë jokontestimore, (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 9/2008)

<sup>96</sup> Ligji për procedurë kontestimore (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 79/2005)

### 1.2.1 Ndarja e pronës së përbashkët në procedurë jokontestimore

Kemi ndarje të pronës së përbashkët në procedurë jokontestimore kur bashkëshortët nuk kanë konflikt, mirëpo nuk mund që të merren vesh lidhur me ndarjen e pronësisë së përbashkët. Në Republikën e Maqedonisë, LPDTS në nenin 75 parasheh: “Nëse nuk merren vesh, ndarjen e pasurisë së përbashkët, me kërkesë të njërit bashkëshort do ta bëjë gjykata në procedurë jokontestimore.” Me propozimin me shkrim të paraqitur nga bashkëshorti ose të dy bashkëshortët njëkohësisht drejtuar gjykatës kompetente fillon procedura jokontestimore. Ky propozim me shkrim i palëve duhet të përmban të dhënat e duhura: vendi ku ndodhet sendi për të cilin kërkohet ndarja, të drejtat e titullarëve tjerë mbi atë send si dhe dëshmi për të drejtën e pronësisë mbi sendin e paluajtshëm.

Sipas zgjidhjeve normative të ofruara nga Ligji për procedurë jokontestimore (2008) ndarja e pronësisë së përbashkët në rastet kur nuk egziston kontesti është lënë në kompetencë të noterëve, të cilët, në cilësinë e të besuarve të gjykatës kanë të drejtë të veprojnë, duke bërë ndarjen e pronësisë së përbashkët në formë të aktit noterial.<sup>97</sup> Angazhimi i noterëve në procesin e ndarjes së pronësisë së përbashkët, është një nga risitë kryesore që solli ky ligj dhe është në vazhden e aktiviteteve të ligdhënësit për të shkarkuar gjykatën nga çështjet jokontestimore, dhe për të rritur efikasitetin e punës së saj, si kusht i rëndësishëm për realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjes gjyqësore.<sup>98</sup>

Për vendosje mbi propozimin është kompetente në pikpamje territorial gjykata në rajonin e së cilës gjenden sendet ose pasuria që duhet ndarë, e në qoftë se sendet ose pasuria e përbashkët gjenden në rajonin e disa gjykatave, kompetentë është secila nga këto gjykata.<sup>99</sup> Ndarja e pronësisë së përbashkët në procedurë jokontestimore bëhet vetëm në bazë të propozimit me shkrim drejtuar gjykatës kompetente.<sup>100</sup>

Gjykata në seancë gjyqësore për ndarjen e pronës së përbashkët në bazë të propozimit për ndarje, përveç bashkëshortëve mund të thërasë edhe subjektet tjera të cilat mund të kenë ndonjë të drejtë sendore mbi sendet që janë objekt i ndarjes së pasurisë së përbashkët, ku gjykata do të

---

<sup>97</sup> Neni 213, paragr. 2, Zakon za vonparnicna postapka, me përkthim: Ligji për procedurë jokontestimore, (‘Gazeta zyrtare e RM-së’ nr. 9/2008)

<sup>98</sup> Zendeli Emine, Risitë e ligjit mbi procedurën jokontestimore, Vizione 11/12, Shkup, 2009, fq. 86

<sup>99</sup> Brestovci Faik, E drejta e procedurës civile II, Prishtinë, 2004, fq.260

<sup>100</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.5

vendosë edhe për të drejtat e tyre.<sup>101</sup> Kjo nënkupton se gjykata në mënyrë ligjore bën pjestimin e pasurisë së përbashkët duke përfshirë edhe persona të tjerë përveç bashkëshortëve, të cilët mund të kenë të drejtë sendore mbi sendet që paraqiten si objekt në ndarjen e pasurisë së përbashkët.

Gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët me kërkesë të bashkëshortit, në pjesën e tij në rend të parë do të hyjnë ato sende nga pasuria e përbashkët, të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së tij.<sup>102</sup> Gjithashtu këtë dispozitë e parasheh edhe Ligji i Familjes së Kosovës në nenin 90 paragrafi 4, i cili nën parasheh se, kur pjestimi fillohet me kërkesën e njërit bashkëshort, atij do t'i dorëzohen ato sende të pasurisë së përbashkët që i shërbejnë ekskluzivisht përdorimit të tij personal. Prandaj, ky paragraf tregon se sendet personale nuk do të jenë objekt i ndarjes në mes bashkëshortëve, por sipas ligjit *ex lege* i takojnë bashkëshortit që i ka përdorur. Përjashtimisht, kur vlera e sendit është më e lartë, në krahasim me vlerën e pasurisë së përbashkët ndahen edhe sendet personale.<sup>103</sup>

Propozim për ndarjen e pronësisë së përbashkët, mund të bëjë njëri ose që të dy bashkëshortët. Nëse ndarjen e pronësisë së përbashkët e dëshiron vetëm njëri nga bashkëshortët, këtë mund ta bëjë me anë të propozimit me shkrim, të cilin e parashtron në gjykatë.<sup>104</sup> Propozim për ndarjen e pronësisë së përbashkët, mund të bëjnë edhe të dy bashkëshortët, atëherë kur që të dy dëshirojnë ndarjen e pronësisë së përbashkët, pasi nuk arrijnë të merren vesh lidhur me administrimin dhe disponimin me pronësinë e përbashkët, ndërkohë që nuk mund të merren vesh as për ndarjen e saj.<sup>105</sup> Propozimi për ndarje të pronësisë së përbashkët duhet që të përmbanë të gjitha të dhënat për sendet që përbëjnë pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, për pronësinë e përbashkët të cilën bashkëshortët kërkojnë që t'a ndajnë në pronësi të veçantë, vendin ku ato ndodhen, si edhe për pronarët dhe titullarët e tjerë që kanë ndonjë të drejtë sendore mbi këto sende të cilat janë objekt i pasurisë së përbashkët. Nëse objekt i ndarjes është paluajtshmëria,

---

<sup>101</sup> Neni 218, Zakon za vonparnicna postapka, me përkthim: Ligji për procedurë jokontestimore, ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 9/2008)

<sup>102</sup> Nenin 76, al.1, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>103</sup> Gashi Haxhi, Aliu Abdulla, Vokshi Adem, Komentari, *Ligji për Familjen i Kosovës*, Ligji nr.2004/32, Prishtinë 2012

<sup>104</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.5

<sup>105</sup> Neni 215, Zakon za vonparnicna postapka, me përkthim: Ligji për procedurë jokontestimore, ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 9/2008)

propozimit për ndarje duhet t'i bashkangjitet edhe dëshmia për egzistimin e së drejtës së pronësisë dhe për të drejtat eventuale të personave të tretë mbi këtë paluajtshmëri.<sup>106</sup>

Palët në procedurë mund që të lidhin pajtim (ujdi) për ndarjen e pasurisë së përbashkët, respektivisht për pasurinë e paluajtëshme. Në qoftë se palët lidhin ujdi për ndarjen e pasurisë së përbashkët atëherë gjykata marrëveshjen e tillë do ta përpilojë në procesverbal. Natyrisht, gjykata do të ketë parasysh që ujdija e tillë mos të jetë në kundërshtim me dispozitat e karakterit imperativ<sup>107</sup>, në të kundërtën pala ka të drejtë të kërkojë anulimin e ujdisë gjyqësore e cila është lidhur nën ndikimin e lajthimit, këcënimit ose dhunës. Në këtë kontekst, po i referohemi një vendimi të Gjykatës supreme të Maqedonisë, të sjellur sipas padisë për anulimin e ujdisë gjyqësore të palëve, lidhur me mënyrën e ndarjes së sendeve në pronësi të përbashkët, të arritur para gjykatës në pajtim me (nenin 220) të Ligjit për procedurë jokontestimore (2008). Duke vepruar sipas padisë së paditëses (bashkëshortes) e cila kërkon anulimin e ujdisë gjyqësore me pretendimin se në momentin e lidhjes së saj ka qenë nën këcënim, pas konstatimit të gjendjes faktike, gjykata ka sjellur vendim me të cilën ka pranuar kërkesëpadinë si të bazuar dhe ka anuluar ujdinë gjyqësore të palëve.<sup>108</sup>

Pasi bëhet ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë jokontestimore, kjo pasuri bëhet pasuri e veçantë e tyre. Në qoftë se gjatë procedurës jokontestimore të ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve paraqitet ndonjë kontest, atëherë ndërpritet procedura jokontestimore dhe fillon çështja në procedurë kontestimore. Në qoftë se gjykata duke vepruar sipas propozimit konstaton se ndërmjet bashkëpjesëtarëve është kontestuese e drejta e pronësisë mbi sendin që është objekt i ndarjes ose e drejta mbi pasurinë, ajo e ndërpret procedurën dhe e udhëzon propozuesin që brenda afatit 30 ditor ta inicojë me padi procedurën kontestimore.<sup>109</sup>

---

<sup>106</sup> Po aty, Neni 216, paragr.1, 2

<sup>107</sup> Neni 220, Zakon za vonparnicna postapka, me përkthim: Ligji për procedurë jokontestimore, ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 9/2008)

<sup>108</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.6 , Odluka na vrhovniot sud na Makedonija, („Sl. vesnik na RM” br. 39/ 91, Bilten 55-56 / 91, odluka 37

<sup>109</sup> Brestovci Faik, E drejta e procedurës civile II, Prishtinë, 2004, fq.261

### 1.2.2 Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë kontestimore

Në procedurë kontestimore, trajtohen çështje të ndarjes së pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, atëherë kur në mes bashkëshortëve paraqitet konflikt për ndarjen e pasurisë së përbashkët, ose ekziston konflikt rreth mënyrës së fitimit të pasurisë së përbashkët të tyre, si edhe konflikte të kohës se kur e kanë fituar pasurinë e cila do të jetë objekt i ndarjes së pasurisë së përbashkët. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve sipas rregullave të procedurës kontestimore, bëhet atëherë kur ndërmjet bashkëshortëve egziston konflikti lidhur me lartësinë e pjesëve të tyre në pronësinë e përbashkët, ose lidhur me mënyrën dhe kohën e fitimit të tyre.<sup>110</sup>

Procedura kontestimore për ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve inicohet me anë të padisë<sup>111</sup>. Padia mund të inicohet nga të dy bashkëshortët. “Pa padi si veprim dispozitiv nuk ka procedurë kontestimore – nemo iudex sine actore.”<sup>112</sup> Në bazë të të dhënave që janë shkruajtur në padi, gjykata do të caktojë lartësinë e pjesës së bashkëshortit. Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në rastë konflikti nuk është diçka e lehtë për tu bërë, sepse nuk është e lehtë që të caktohet pjesa e pasurisë së përbashkët e fituar gjatë martesës. Në qoftë se bashkëshortët nuk kanë lidhur ndonjë kontratë për pasurinë e tyre të përbashkët (në vendet të cilat vlenë regjimi pasuror i kontraktuar), atëherë normat juridike të vendit rregullojnë ndarjen e pronësisë së tyre të përbashkët.

Supozimi ligjor se bashkëshortët janë pronarë në pjesë të barabarta të sendeve në pronësi të përbashkët, mund të bjen poshtë nëse bashkëshorti deklaron, dëshmon dhe argumenton se pjesa e tij është më e madhe se pjesa e bashkëshortit tjetër, që nënkupton caktimin e pjesës së tij në bazë të kontributit.<sup>113</sup>

Për vlerësimin e pasurisë së përbashkët në rast mosmarrëveshje, LFK neni 54 parasheh: ”nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të

---

<sup>110</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.8

<sup>111</sup> Padia është veprim procedural me të cilin inicohet procedura kontestimore për mbrojtjen e ndonjë të drejte subjektive civile të rrezikuar ose të shkelur

<sup>112</sup> Janevski Arsen, Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedurale civile, Libri i parë, E drejta kontestimore, Shkup, 2011, përkthim: Zendeli Emine - Zendeli Nagip, fq.317

ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.”

Edhe pse, gjykata në parim niset nga supozimi ligjor i përmbajtur në nenin 75, al.2, të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (2001), sipas të cilit, pronësia e përbashkët e bashkëshortëve duhet të ndahet në pjesë të barabarta, që do të thotë se çdonjëri nga bashkëshortët është pronar i 1/2 pjesë ideale në pronësinë e përbashkët<sup>114</sup>, megjithatë, çdonjëri nga bashkëshortët ka të drejtë që të rrëzojë supozimin e tillë dhe të dëshmojë se pjesa e tij është më e madhe se pjesa e bashkëshortit tjetër.<sup>115</sup> Me kërkesë të njërit nga bashkëshortët, gjykata mund t’i ndajë pjesën më të madhe të sendeve në pronësi të përbashkët, bashkëshortit i cili arrinë të argumentojë se kontributi i tij në fitimin e pronësisë së përbashkët është dukshëm më i madh se kontributi i bashkëshortit tjetër.<sup>116</sup> Sipas kësaj nënkuptojmë aftësinë e bashkëshortit i cili ka mundësi t’i paraqet gjykatës më shumë argumente në krahasim me bashkëshortin tjetër, në lidhje me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve. Edhe pse bashkëshorti i paaftë do ti takonte një vlerë e caktuar nga pasuria e përbashkët, mirëpo nga paaftësia do të humb pasurinë përpara gjykatës duke mos i’u vërtetuar atë pasuri të cilën do ta kishte përfituar me anë të kontributit të saj.

Kështu në një aktgjykim të Gjykatës themelore në Tetovë, kërkesëpadija e (paditëses) bashkëshortes është pranuar vetëm pjesërisht, sepse ajo nuk ka arritur të argumentojë kontributin e pretenduar. Në kërkesëpadi paditësja (bashkëshortja), kërkon nga gjykata që të vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi 1/2 pjesë ideale të shtëpisë, duke pretenduar se ajo është ndërtuar nga mjetet e fituara me punë gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, ndërkohë që gjykata ka vërtetuar se paditëses i takon vetëm 1/10 e ndërtesës. Me këtë rast gjykata nuk ve në dyshim faktin se ajo është kujdesur për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, si edhe për punët e tjera të amvisërisë, mirëpo, edhe pse ka pasur licencë për mjeshtëri ondulimi ajo ka ushtruar këtë

---

<sup>114</sup> Neni 75, paragr. 2, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore të RM-së, 2001

<sup>115</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.8

<sup>116</sup> Neni 75, paragr. 3, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore të RM-së, 2001

profesion për një kohë shumë të shkurtër, ashtuqë nuk ka pasur mundësi të krijojë të ardhura me efekt financiar, me të cilat do të kontribonte në ndërtimin e shtëpisë. Në anën tjetër i padituri (bashkëshorti) ka arritur që me argumente ta bindë gjykatën se mjetet për ndërtimin e shtëpisë i ka krijuar vetë ai duke punuar në një periudhë prej 13 vitesh jashtë shtetit. Në këtë mënyrë i padituri (bashkëshorti) ka arritur të argumentojë se ai ka dhënë kontribut dhjetë herë më të madh se paditësja (bashkëshortja) në fitimin e mjeteve për ndërtimin e shtëpisë.<sup>117</sup>

Gjykata në rastin e përcaktimit të kontributit të bashkëshortit në fitimin e pronësisë së përbashkët merr parasysh kontributin financiar si dhe ndihmën e dhënë bashkëshortit tjetër, me punë, amvisëri, kujdesin për fëmijët dhe edukimin e tyre. Më anë të këtij rasti, gjykata tenton në zbatimin e supozimit ligjor mbi barazinë e palëve, të bashkëshortit të pa punësuar, ku në shumicën e rasteve e papunësuar është gruaja.

Lidhur me mënyrën se si do të ofrohet kontributi i bashkëshortëve për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga martesë, në nenin 54 të Kodit të Familjes thuhet shprehimisht:” Në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesë, nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.”<sup>118</sup> Sipas kësaj dispozite ligjvënësi nuk ka përcaktuar saktësisht mënyrën se si do të ofrohet kontributi nga bashkëshortët, si dhe ju lejon bashkëshortëve që të zgjedhin mënyrën e ofrimit të kontributit në pasurinë e përbashkët.

Ekzistojnë raste kur prindërit e njërit bashkëshort investojnë vlerën më të madhe të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Kështu, p.sh. gjatë ndërtimit të shtëpisë së përbashkët në bashkësi martesore, prindërit e njërit bashkëshort kanë investuar gjysmën e mjeteve të nevojshme (mjete që nuk janë krijuar në bashkësi martesore) për ndërtimin e saj. Prandaj në këtë rast 1/2 e shtëpisë përbën pronësinë e

---

<sup>117</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na osnoven sud Tetovo, P.br. 423/1997, 15.10.1997

<sup>118</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, ”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.244

veçantë të bashkëshortit prindërit e të cilit kanë investuar në ndërtimin e shtëpisë, ndërsa pjesa tjetër si pronësi e përbashkët do të ndahet në pjesë të barabarta ndërmjet bashkëshortëve.<sup>119</sup>

Gjykata themelore, Shkup II, e ka pranuar vetëm pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit (bashkëshortit), me të cilën ai kërkon vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ½ e banesës, me pretendimin se ajo është blerë me mjete nga pronësia e përbashkët. Në arsyetimin e gjykatës thuhet se, banesa prej 42 m<sup>2</sup> dhe podrum prej 4 m<sup>2</sup> në Rr. B. K. nr., është blerë me mjetet në të holla të prindërve të bashkëshortes, që do të thotë se nuk bëhet fjalë për send që është blerë me mjete të përbashkëta, të fituara në martesë, por me mjete, të cilat prindërit ia kanë dhuruar ekskluzivisht bashkëshortes. Mirëpo, në ndërkohë banesa është zgjeruar edhe për 9 m<sup>2</sup> hapësirë banimi, dhe 10 m<sup>2</sup> ballkon, pra 51 m<sup>2</sup> banesë dhe 4 m<sup>2</sup> podrum, gjithsej 65 m<sup>2</sup>. Në punët e ndërmarra për zgjerimin e banesës kanë kontribuar të dy bashkëshortët, bashkëshorti me mjete të marra me kredi dhe me punë fizike, ndërsa bashkëshortje me mjete në të holla që ia kanë dhënë prindërit e vet. Pasi në këtë rast gjykata nuk mund të konstatojë kontribut më të madh të ndonjërit nga bashkëshortët, të dyve u njeh nga ½ pjesë ideale të pjesës së zgjeruar të banesës. E drejta e pronësisë së paditësit, që e ka fituar me dhënien e kontributit në zgjerimin e banesës duhet të shprehet në pjesë ideale në raport me banesën në tërësi, sepse pjesa e zgjeruar nuk paraqet tërësi të veçantë, e as objekt të veçantë ndërtimor që të mund të konstatohet e drejta e pronësisë vetëm mbi pjesën e zgjeruar, prandaj në raport me tërë sipërfaqen e banesës këto 10 m<sup>2</sup> të paditësit paraqesin përafërsisht 1/6 e tërë banesës lidhur me të cilën gjykata ia ka pranuar kërkesëpadinë si të themeltë dhe ka urdhëruar bashkëshorten që të durojë ndryshimin në librin publik.<sup>120</sup>

---

<sup>119</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na Osnovniot sud Skopje II, 05.06.2007 VIII П.бп. 250/05

<sup>120</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na Osnovniot sud Skopje II, 05.06.2007 VIII П.бп. 250/05



### **1.3 Subjektet me të drejtë kërkesë për ndarje të pronësisë së përbashkët**

Si subjekt primar me të drejtë kërkesë për ndarje e pronësisë së përbashkët paraqiten bashkëshortët, ku si objekt i ndarjes së pronësisë së përbashkët konsiderohen vetëm ato sende të luajtshme ose të paluajtshme, si dhe kontributi i tyre në mënyrë financiare apo ndonjë mënyrë tjetër, të cilat bashkëshortët i kanë fituar bashkërisht nga lidhja martesore deri në shkurorëzimin e saj.

Përveç bashkëshortëve si subjekte me të drejtë kërkesë për ndarjen e pronësisë së përbashkët, sipas Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore në nenin 64 parashesh: "Të drejtë të kërkojnë që të vërtetohet se çfarë pjese pronësore i takon pronarit të përbashkët në emër të pjesës së tij në pronësinë e përbashkët kanë: kreditori sa i përket pjesës së dëbitorit të tyre, trashëgimtarët sa i përket pjesës së trashëgimisë, dhe secili sa i përket pjesës së çdo pronari të përbashkët, nëse për atë ka interes juridik."

Ndërsa Ligji i Familjes së Kosovës në nenin 56 paragrafi 2 parashesh: "Të drejtë që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose bashkëshortit të shpallur për të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti."

Ndryshe nga LPDTS i RM-së dhe nga LFK, Kodi i Familjes i Shqipërisë për kreditorin si subjekt neni 98 thekson se: "Kreditorët e njërit bashkëshort nuk mund të kërkojnë vetë ndarjen e pasurisë." Duke shtuar edhe në nenet në vijim se vetëm atëherë kur procedura për ndarjen e pasurisë së bashkëshortëve ka filluar, kreditorët kanë të drejtë që të njihen me kërkesën e bashkëshortëve për ndarjen e pasurisë së përbashkët si dhe dokumentat e paraqitura nga bashkëshortët, po ashtu të ndërhyjnë në seancë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre si kreditorë.<sup>121</sup>

Kërkesa për ndarjen e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve nuk parashkruhet. Bashkëshorti dhe subjektet e tjera të legjitimuara aktivisht për të kërkuar ndarjen e pronësisë së përbashkët kanë të drejtë që në çdo kohë të kërkojnë ndarjen e pronësisë së përbashkët. Është e

njohur se, për sa kohë zgjatë martesë ndërmjet bashkëshortëve, nuk rjedh afati i parashkrimit të kërkesave.<sup>122</sup>

Nëse martesë ka pushuar me shkurorëzim, ose anulim të saj, e drejta nga neni 75, al.3, që autorizon bashkëshortin të kërkojë nga gjykata që t'i përcaktojë pjesën më të madhe në pronësinë e përbashkët, duke pretenduar se ka dhënë kontribut më të madh në fitimin e saj, i takon vetëm ish bashkëshortit e jo edhe trashëgimtarëve të tij.<sup>123</sup>

Është me rëndësi të theksohet se pronësia e përbashkët e bashkëshortëve nuk pushon me falimentim, pasi në procedurë të falimentimit nuk bëhet ndarja e pronësisë së përbashkët.<sup>124</sup> Nëse bashkëshortët me marrëveshje me shkrim janë dakorduar që njëri prej tyre të administrojë dhe disponojë me pronësinë e përbashkët ose me pjesë të saj, ndërkohë që procedura e falimentimit hapet ndaj pronësisë së këtij bashkëshorti, atëherë pronësia e përbashkët në tërësi, ose pjesa e saj, për të cilën janë marrë vesh me kontratë përfshihet në masën e falimentimit.<sup>125</sup> Kjo nuk do të ndodhë nëse bashkëshortët bashkërisht dhe me marrëveshje administrojnë dhe disponojnë me pronësinë e përbashkët.<sup>126</sup>

---

<sup>122</sup> Neni 370, paragr.1, Ligji për marrëdhënie detyrimore ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 53/2001")

<sup>123</sup> Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.12, Odluka na Vrhovniot sud na Makedonija, Rev.br. 21/90 „Zbirka na sudski odluki”, kniga IV, obl. 3

<sup>124</sup> Neni 76, paragr. 3, Ligji për falimentim ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 34/2006)

<sup>125</sup> Po aty, neni 76, p.aragr.1

<sup>126</sup> Po aty, neni 76, paragr.2

#### **1.4 Sendet e privileguara në ndarjen e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve**

Sipas ligjit të Republikës së Maqedonisë ekzistojnë disa sende të cilat janë të konsideruara si sende të privileguara dhe të cilat sende nuk trajtohen njëjtë me sendet e pronës së përbashkët. LPDTS i Republikës së Maqedonisë këto sende janë të numëruara taksativisht në nenin 76 dhe 77 ku parasheh:

- Sendet të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së tij
- Sendet të cilat shërbejnë për përdorimin personal të tij
- Sendet të cilat ju shërbejnë fëmijëve ose janë të dedikuar vetëm për përdorim të drejtëpërdrejtë nga ana e tyre, më konkretisht sendet që duhet ti takojnë bashkëshortit të cilit janë besuar fëmijët për rritje dhe edukim.

Si sende të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së bashkëshortit e të cilat konsiderohen si sende të privileguara janë: makina, instrumenti muzikor, sallon ondulimi, etj., këta sende me pëlqimin e bashkëshortit tjetër ia bën kompezimin e duhur.

Si sende të cilat shërbejnë për përdorimin personal të tij, si përshebull: veshëmbathjet, pikturat, librat, etj., edhe pse janë të fituara gjatë lidhjes martesore ato sende nuk mund të ndahen.

Si sende të cilat i takojnë bashkëshortit të cilit janë besuar fëmijët për rritje dhe edukim (librat, veshmbathjet, lodrat, etj.) me qëllim që t'i shërbejnë fëmijëve nuk mund që të ndahen.

Me rastin e pjestimit të pasurisë së përbashkët, borxhi i pasurisë së përbashkët do të llogaritet në pjesën e secilit bashkëshort. Kur bëhet pjestimi i pasurisë me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve të një martese ligjrisht të regjistruar, duhet kushtuar vëmendje për të siguruar që pjesa e tij/saj përfshinë ato sende të pasurisë së përbashkët, të cilët i shërbejnë zanatit apo profesionit të tij/saj. Nëse vlera e sendeve nga paragrafi 2 i këtij neni është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët, do të bëhet edhe pjestimi i atyre sendeve, përveç nëse bashkëshorti të cilit këto pjesë duhet t'i takojnë nuk ia siguron bashkëshortit tjetër pagimin përkatës në para apo vlerën përkatëse ose të përafërt ose nuk ia cedon bashkëshortit tjetër sipas pëlqimit të tij sendet tjera me vlerë përkatëse ose të përafërt. Për këto kompensime qëllimi kërkohet të miratohet nga dy bashkëshortët. Kur pjestimi fillohet me

kërkesën e njërit bashkëshort, atij do t'i dorëzohen ato sende të pasurisë së përbashkët që i shërbejnë ekskluzivisht përdorimit të tij personal.<sup>127</sup>

### **1.5 Pasojat e pushimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve**

Me ndarjen e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, si rezultat paraqiten pasojat e caktuara të cilat rrjedhin nga ndarja e pronësisë së përbashkët të tyre. Pasojat e pushimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve saktësisht janë pasoja në të cilat paraqiten si objekt sendet e luajtshme ose të paluajtshme të bashkëshortëve, ku me ndarjen e pronësisë së përbashkët të tyre, duhet që objektet të ndahen në pjesë të caktuara sipas rrethanave të cilat do t'i vërteton gjykata, si dhe për vendimin që do të sjell ajo.

Ekzistojnë pasoja të cilat rrjedhin nga ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve gjatë ekzistimit të martesës, si dhe pasoja të cilat rrjedhin nga ndarja e pronësisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës. Nëse ndahet pronësia e përbashkët e bashkëshortëve gjatë ekzistimit të martesës ose pas shkurorëzimit të saj, pronësia e përbashkët shëndërrohet në pronësi të veçantë të bashkëshortëve. Përveç atëherë kur gjatë ekzistimit të martesës bëhet ndarja e pronësisë së përbashkët krijohet pronësia e veçantë e bashkëshortëve, por me vazhdimin e martesës së bashkëshortëve përsëri pasuria tjetër që do ta fitojnë bashkëshortët do të konsiderohet si pronësi e përbashkët e tyre. Ndërsa nëse bashkëshortët janë të shkurorëzuar, pasuria të cilën ata do ta fitojnë do të konsiderohet si pasuri e veçantë.

Bashkëshortët me anë të marrëveshjes së tyre kanë mundësi që të bëjnë ndarjen e pronësisë së përbashkët. Në qoftë se një ndarje e tillë nuk ka efekt, atëherë ndarja e pasurisë së përbashkët do të kalon nëpër rrugë gjyqësore. Nëpër rruget gjyqësore çështja në fillim kalon nëpërmjet procedurës jokontestimore përderisa nuk paraqitet ndonjë konflikt në mes palëve. Në momentin e paraqitjes së ndonjë konflikti në ndarjen e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve atëherë gjykata e udhëzon palët që të kalojnë në procedurë kontestimore. Gjukata do të vendos se cila pasuri kujt do ti takon dhe do të bëjë pjestimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, si dhe do ta shëndron pasurinë e përbashkët në pasuri të veçantë dhe pas kësaj bashkëshortët lirshëm do të disponojnë me pasurinë e tyre të veçantë.

---

<sup>127</sup> Neni 90, par.1,2,3,4, Ligji për Familjen i Kosovës, Nr.2004/32

## 1.6 Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve

Bashkëshortët kanë detyra dhe përgjegjësi reciproke ndaj tyre, si në martesë po ashtu edhe pas mbarimit të martesës. Përveç detyrimeve reciproke të bashkëshortëve, ata kanë detyrime edhe ndaj personave të tretë.

Për detyrimet që njëri bashkëshort i ka pasur para lidhjes së martesës, si edhe për detyrimet personale që do t'i pranojë pas lidhjes së martesës nuk përgjigjet bashkëshorti tjetër.<sup>128</sup> Detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës ose që rëndojnë trashëgimitë dhe dhurimet që fitojnë gjatë martesës mbeten detyrime vetjake.<sup>129</sup> Bashkëshortët përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet të cilat njëri bashkëshort i ka pranuar ndaj personave të tretë për mbulimin e nevojave rrjedhëse të bashkësisë martesore, si dhe për detyrimet që sipas dispozitave të përgjithshme i ngarkojnë të dy bashkëshortët. Bashkëshorti i cili prej pasurisë së tij të veçantë e ka përmbushur detyrimin solidar ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti tjetër që të kompensojë pjesën e detyrimit që bie mbi të.<sup>130</sup>

Ligji për Familje i Kosovës në nenin 57 parasheh se “bashkëshortët janë përgjegjës për detyrimet e tyre personale që rezultojnë nga pasuria e pjesëtuar dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga pjesa e tyre në pasurinë e përbashkët”. Në këtë nen ligjvënësi na bën që të kuptojmë se bashkëshortët kanë dy lloj detyrimesh që janë detyrimet e veçanta dhe të përbashkëta, që dalin nga pasuria e veçantë dhe pasuria e përbashkët e bashkëshortëve.

Të dy bashkëshortët janë të ngarkuar me detyrimet e përbashkëta dhe individuale përmes pasurisë së tyre të përbashkët dhe të pjesëtuar, për detyrimet që njërit nga bashkëshortët duhet të përmbush kundrejt personave të tretë si dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga të dy bashkëshortët.<sup>131</sup>

Sa i përket detyrimeve të veçanta, bashkëshorti përgjigjet me anë të pasurisë së veçantë, ndërsa sa i përket detyrimeve të përbashkëta atëherë bashkëshortët përgjigjen me anë të pasurisë

---

<sup>128</sup> Nenin 79, parag.1, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>129</sup> Neni 82, KFSH, Ligji Nr. 9062, 2003

<sup>130</sup> Neni 79, parag.1,2,3, , Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

<sup>131</sup> Neni 57, parag.2, Ligji për Familjen i Kosovës, Nr.2004/32

së përbashkët. Kjo nënkupton detyrimet ndaj një personi të tretë që kanë bashkëshortit për detyrim që ta realizojnë me anë të pasurisë së përbashkët apo veçantë.

Në nenin 81, Kodi i Familjes i Shqipërisë në mënyrë taksative numëron se kur bashkëshortët përgjigjen për pasurinë në bashkësi:

- a) për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë;
- b) për të gjitha shpenzimet e administrimit të pasurisë së përbashkët;
- c) për të gjitha shpenzimet për mbajtjen e familjes dhe për çdo detyrim të kontraktuar nga bashkëshortët, qoftë veçmas, që është në interes të familjes;
- d) për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vetjake në këtë Kod.

Të gjithë legjislacionet e përmendura më lartë përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve. Bashkëshortët duhet që të përgjigjen për të gjitha barrat si dhe detyrimet të cilat bien mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë. Poashtu edhe shpenzimet duhet që ti administrojnë së bashku. Kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e familjes me anë të shpenzimeve të pasurisë së përbashkët, etj. Bashkëshortët janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre.

## KREU I SHTATË

### 1. Mbjajtja financiare dhe ushqim (ALIMENTACIONI)

Mbjajtja financiare nënkupton detyrimin financiar dhe material.<sup>132</sup> Detyrimet për ushqim ndryshe quhet alimentacion. Alimentacioni nënkupton mbajtje në mënyrë financiare dhe ushqim të familjes, konkretisht të bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve si dhe fëmijëve. Detyrimi në ushqim bëhet me anë të hollave, të cilat të holla duhet bërë çdo muaj, në rast se caktohet detyrimi për ushqim në mënyrë ligjore.

Sipas LFK-së veçoritë e detyrimit të mbajtjes janë:

1. mbajtja është detyrim ligjor
2. mbajtja është e drejtë dhe detyrë personale
3. mbajtja jepet për kohën e ardhshme
4. e drejta e mbajtjes nuk parashkruhet
5. mbajtja nuk është dëmshpërblim
6. mbajtja e dhënë nuk kthehet dhe
7. vendimi gjyqësor për dhënien e mbajtjes mund të ndryshohet.<sup>133</sup>

Detyrimi në ushqim është detyrim ligjor dhe të njëjtën kohë është e drejtë personale. Sa i përket detyrimit në ushqim, bashkëshortët nuk mund të heqin dorë si dhe ky llojë detyrimi nuk parashkruhet. Bashkëshortët janë të detyruar në ushqiminë e njëri tjetrit, të cilët duhet që të ndihmojnë dhe sigurojnë njëri tjetrit për përkrahje materiale. Detyrimi në ushqim nuk mund të shihet si dëmshpërblim, sepse nuk jepet ngase ka shkaktuar ndonjë dëm personi që është i detyruar të jep atë. Mbjajtja financiare paraqitet nëse paraqitet kërkesa për dhënien e saj. Ajo jepet vetëm në të ardhmen gjithmonë duke u bazuar në ligj.

Ekzistojnë dy lloje detyrimesh për ushqim ndërmjet bashkëshortëve: gjatë martesës dhe pas zgjidhjes së martesës.

---

<sup>132</sup> Neni 278, Ligji për Familjen i Kosovës, Nr.2004/32

<sup>133</sup> Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, fq.302

### 1.1 Detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve gjatë martesës

Insituti i detyrimit për ushqim lind për shkak të lidhjes që krijohet me martesë, të gjinisë që lidh anëtarët e familjes ose për shkak të birësimit.<sup>134</sup> **Detyrimi për ushqim** është një detyrim ligjor, pa kundërshtim dhe me karakter vetjak, në bazë të të cilit një ose disa anëtarë të familjes detyrohen t'u sigurojnë mjetet e jetesës anëtarëve të tjerë të familjes që janë të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar.<sup>135</sup> Me anë të lidhjes së martesës krijohen të drejta dhe detyrime në mes bashkëshortëve. Si detyrim paraqitet edhe detyrimi i mbajtjes midis bashkëshortëve dhe anëtarëve tjerë të familjes, mirëpor gjatë martesës ajo realizohet me anë të vullnetit si dhe sipas mundësive të bashkëshortëve. Sipas nenit 42 paragrafi 3 të LFK, bashkëshortët janë të detyruar ta ndihmojnë dhe mbështesin financiarisht njëri tjetrin posaçërisht, kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë.

Sipas Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë në nenin 178, paragrafi 2 parasheh atë se “ushqimia e anëtarëve të familjes dhe familjarëve të tjerë është e drejtë dhe detyrim i tyre. Në rastet kur ushqimia reciproke e anëtarëve të familjes dhe familjarëve të tjerë nuk mund të realizohet tërësisht ose pjesërisht, Republika anëtarëve të pasiguruar të familjes ju siguron mjete të nevojshme për ushqim nën kushtet e përcaktuara me ligj.” Ky ligj përcakton ushqiminë si një e drejtë e ish-bashkëshortit që mund të kërkojë nga ish-bashkëshorti tjetër ose si një detyrim që duhet ta përmbushin ish-bashkëshortët ndërmjet veti, si dhe e drejtë e fëmijëve që mund të kërkojnë ushqim nga prindërit si dhe anasjelltas.

Sa i përket LFK, definimin e ushqimisë e përcakton në nenin 297: “Ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve.” Sipas këtij ligji, ushqimia nënkupton atë se ushqimia paraqet mbajtje financiare, në të holla, të ish-bashkëshortit i cili ka të drejtë të kërkojë ushqiminë nga tjetri ish-bashkëshortë, apo të drejtën e fëmijëve që të kërkojnë ushqiminë nga prindërit e tyre.

Kushtet për ekzistencën e detyrimit për ushqim sipas KFSH-së përcaktohen nga dy faktorë: **faktori i parë** lidhet me vlerësimin objektiv që i referohet dy rasteve: a) nevojës dhe b) mundësisë; **faktori i dytë** i qenies së detyrimit për ushqim është ekzistenca e marrëdhënieve të

<sup>134</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, "Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.533

<sup>135</sup> Ksanthipi Begeja, E drejta martesore e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985, fq. 228



gjinisë, farefisnisë (në atë gradë ose shkallë që ligji i përcakton), d.m.th e marrëdhënieve të afërta me personat që kanë një mundësi ekonomike të tillë, që t'u bëjë të mundur të kontribuojnë për plotësimin e nevojave të domosdoshme jetësore të përfituesit të detyrimit për ushqim, kuptohet pasi të kenë përmbushur nevojat e tyre dhe të familjes së tyre.<sup>136</sup>

Veçoritë e KFSH të vitit 2003 për detyrimin për ushqim janë si vijon: a) e drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim është një e drejtë vetjake dhe nuk mund t'i kalojë një personi tjetër. Një gjë e tillë parashikohet shprehimisht në nenin 213, par.1, i KFSH-së, ku përcaktohet se: "e drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim nuk mund t'i kalojë një personi tjetër"; b) një nga vecoritë, që e dallon detyrimin për ushqim nga detyrimet e tjera, është natyra e tij e ndryshueshme, kurse detyrimet e tjera (p.sh: detyrimi nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor),një herë të përcaktuara, janë të pandryshueshme, pavarësisht nga ndryshimi i gjendjes ekonomike të të detyruarit; c) detyrimi për ushqim mund të kërkohet vetëm për kohën e ardhme; d) e drejta e kërimit për ushqim është e paparashkrueshme; e) heqja dorë nga e drejta e kërimit të detyrimit për ushqim nuk sjell pasoja juridike; f) detyrimi për ushqim është i pasekuestrueshëm, i pazëvendësueshëm dhe i pakompensueshëm.<sup>137</sup>

Ajo që na intereson më shumë dhe që është më e rëndësishme është detyrimi për ushqimin ndërmjet bashkëshortëve pas martesës. Edhe pse ky aspekt formalisht është i rregulluar në mënyrë perfekte të mundshme, mirëpo sa i përket jetës reale aplikohet tjetër.

---

<sup>136</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaç Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,"Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.535,537

<sup>137</sup> Po aty, fq.538

## 1.2 Detyrimi i mbajtjes ndërmjet bashkëshortëve pas shkurorëzimit të martesës

Me pushimin e martesës së bashkëshortëve, lindin detyrime të bashkëshortëve të cilat detyrime janë paraparë me ligj. Marrëdhëniet e detyrimit për mbajtjen e bashkëshortëve në Republikën e Maqedonisë rregullohen me Ligjin për Familje (2014). Edhe pse detyrimet për ushqim janë të parashikuara për të dy bashkëshortët, megjithëse gruaja është ajo e cila në rajonet shqiptare ka nevojë për të kërkuar këtë detyrim. Për arsyë se ligjvënësi ka përcaktuar dispozitat se kush ka të drejtë për të kërkuar detyrimet për ushqim, ku përcakton në neni 185 parag.1 dhe 2 të Ligjit për Familje të RM-së: “Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vet, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësinë e tij. Gjykata mund, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, ta refuzojë kërkesën për ushqim në qoftë se këtë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq ose pa shkaqe të arsyeshme e ka braktisur bashkëshortin nga i cili kërkon ushqim.”<sup>138</sup> Të njëjtën e parasheh edhe Ligji për Familje i Kosovës nr.2004/32 në nenin 298 parag.1 dhe 2.

Për detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve Kodi i Familjes i Shqipërisë në nenin 199 parasheh “Bashkëshorti që është i paaftë për punë dhe pa mjete të mjaftueshme për të jetuar ka të drejtë të kërkojë ushqimin nga bashkëshorti tjetër. Detyrimi për ushqim kërkohet në të njëjtën kohë me padinë për zgjidhjen e martesës. Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe brenda 6 muajve, nga data e vendimit për zgjidhje të martesës ka marrë formë të prerë, me kusht që paaftësia dhe mungesa e mjeteve të pamjaftueshme për të jetuar të kenë ekzistuar gjatë martesës.”<sup>139</sup>

Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqimin nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë.<sup>140</sup> Bashkëshortit të cilit i takojnë fëmijët për rritje dhe kujdesje, i takon ushqimi nga bashkëshorti tjetër i cili e ka për detyrë që ta realizoj ushqimin ndaj tyre.

---

<sup>138</sup> Neni 185, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>139</sup> Neni 199, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

<sup>140</sup> Gashi Haxhi, Aliu Abdulla, Vokshi Adem, Komentar i Ligji nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, Prishtinë, 2012, fq.624

Nën kushtet e nenit 186 të LPDTS bashkëshorti i pasiguruar ka të drejtë të kërkojë që me anë të aktgjykimit me të cilin shkurorëzohet martesë të gjykohej një shumë e caktuar e të hollave në emër të ushqimit në barrë të bashkëshortit tjetër në proporcion me mundësitë e tij.<sup>141</sup>

Neni 301 i LFK, në detyrimin për ushqim për shkak të sëmundjes apo paaftësisë parasheh atë se: “Bashkëshorti i shkurorëzuar mund të bëjë kërkesë për ushqim nga bashkëshorti tjetër nëse dhe që nga momenti i shkurorëzimit, mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmijës të përbashkët dhe përfundimit të kushteve të parashikuara në nenin 302<sup>142</sup> të këtij ligji ai nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave të tija psikike apo mentale.”<sup>143</sup>

Për të kërkuar bashkëshorti ushqiminë nga bashkëshorti tjetër pas shkurorëzimit duhet që ushqimi të jetë i nevojshëm dhe bashkëshorti që kërkon ushqimin të ketë mungesë të mjeteve materiale apo të jetë i paaftë për punë. Shumë qartë ligjvënësi e ka përcaktuar në nenin 304 të LFK ku parasheh: “Bashkëshorti i shkurorëzuar nuk mund të kërkojë ushqiminë për derisa ai është në gjendje të mbaj vetën nga të ardhurat apo nga pasuria e tij.”<sup>144</sup>

Neni 196 i Ligjit për Familje të RM-së përcakton shprehimisht: “Lartësinë e ushqimit gjykata mund ta përcaktojë në vlerë të caktuar apo në përqindje me të ardhurat e realizuara personale, gjegjësisht nga fitimi dhe të ardhurat e realizuara nga ndonjë veprimtari tjetër.”<sup>145</sup> Gjykata gjatë përcaktimit të lartësisë së ushqimit do ta përcakton duke u bazuar tek të ardhurat e bashkëshortit i cili e kërkon ushqiminë.

Gjatë përcaktimit të ushqimit gjykata mer parasysh gjendjen pasurore, shëndetsore, punësimin, se kush ka qenë fajtor për ardhjen e shkurorëzimit, të vërtetohet se nevojshmëria e mbajtjes a është e shkaktuar me qëllim, etj. Kjo bëhet me qëllim që mos të dëmtoj asnjërën palë, palën që ska të mira materiale të mos e detyron për ushqiminë ndaj palës tjetër, si dhe në qoftë se njëra palë ka të mira materiale, të ketë detyrim për palën tjetër që nuk ka gjendje ekonomike të mirë përshkak të pamundësisë, të papunësisë apo paaftësisë për të punuar.

---

<sup>141</sup> Neni 186, parag.1, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>142</sup> Neni 302, Ushqimia për shkak të papunësisë, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>143</sup> Neni 301, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>144</sup> Po aty, Neni 302

<sup>145</sup> Neni 196, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

Për përcaktimin e ushqimit, Ligji për Familje i RM-së në nenin 194, në paragrafet 1, 2, 3 parasheh: “Gjatë përcaktimit të nevojës për ushqim të personit, gjykata do të marrë parasysh gjendjen e tij pronësore, aftësinë për punë, mundësinë për punësim, gjendjen shëndetësore, si dhe rrethanat e tjera nga të cilat varet vlerësimi mbi nevojat e tij. Kur përcaktimi i ushqimit bëhet për fëmijë, gjykata do të marrë parasysh edhe moshën e fëmijës si dhe nevojat për shkollimin e tij. Gjatë vërtetimit të mundësive të personit i cili është i obliguar të japë ushqimin gjykata do t’i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij, nevojat e tija personale dhe obligimet e tija ligjore në ushqim të personave të tjerë.”<sup>146</sup>

Me ligj është paraparë së bashkëshorti i ndarë ka të drejtë të kërkojë ushqimin nga bashkëshorti tjetër për shkak të moshës që ka, arsye kjo që bashkëshorti që kërkon ushqimin nuk ka mundësi që të punoj apo të pranohet në marrëdhënie punë për moshën që ka. Këtë dispozitë e parasheh LFK në nenin 300, paragrafi 3, ku përcakton se: “Bashkëshorti i ndarë mund të bëjë kërkesë për ushqimin ndaj bashkëshortit tjetër me përfundim të kushteve të parashikuara në nenin 301<sup>147</sup> dhe 302<sup>148</sup> të këtij ligji ai nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të moshës së tij.”<sup>149</sup>

Në ç’mënyrë përmbushet detyrimi për ushqim? Sipas nenit 209 të Kodit të Familjes së Shqipërisë: “Personi që ka detyrimin për ushqim, ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtëpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht, pse duke e mbajtur në shtëpinë e tij atë që merr detyrimin për ushqim. Gjkata, sipas rrethanave, përcakton mënyrën e dhënies së detyrimit për ushqim. Në rast nevojë urgjente, gjykata vendos detyrimin për ushqim në ngarkim të njërit prej personave të detyruar. Në këtë rast, personi i detyruar ruan të drejtën e padisë së regresit ndaj personave të tjerë.”<sup>150</sup>

Neni 209 i Kodit të Familjes së Shqipërisë paraqet dy alternativa për debitorin e detyrimit ushqimor: ose të paguaj një shumë të caktuar të hollash, ose ta mbajë në shtëpinë e tij kreditorin

---

<sup>146</sup> Neni 194, parag.1,2,3, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>147</sup> Shiko: Neni 301, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>148</sup> Shiko: Neni 302, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>149</sup> Neni 300, paragr.3, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>150</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.545

(përfituesin) e detyrimit për ushqim.<sup>151</sup> Kjo bëhet gjithmonë duke pasur parasysh marrëdhëniet midis kreditorit dhe debitorit të detyrimit për ushqim. Andaj, ligjvënësi ka përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij ligji, se: “Gjykata, **sipas rrethanave**, përcakton mënyrën e dhënies së detyrimit për ushqim.” P.sh., në rastin e zgjidhjes së martesës, kur njëri bashkëshort kërkon detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër, gjykata përcakton mënyrën e pagesës nga ana e bashkëshortit të detyruar.<sup>152</sup>

Detyrimi mund të kufizohet apo shuhet për disa shkaqe që janë paraparë me ligjin e vendit. Në qoftë së kërkesa bëhet për shkaqe të paarsyeshme ajo mund të refuzohet. Sipas LFK, në nenin 306, paragrafi 2, si shkaqe të paarsyeshme për refuzimin e kërkesëpadisë konsiderohen “periudha e kohëzgjatjes së martesës apo periudha për të cilën është ofruar mbajtja për fëmijën e përbashkët ka qenë shumë e shkurt dhe për faktin e martesës ose mbajtjes për çka kërkohet ushqimia; paditësi është fajtor për krim apo sulm të rëndë të paramenduar kundër bashkëshortit tjetër; paditësi me qëllim shkakton nevojshmërinë e tij.” Që nënkupton së kërkesëpadia refuzohet në rast se ish-bashkëshortët nuk kanë qenë në lidhje të gjatë martese apo mbajtja për fëmijën e përbashkët ka qenë aq e shkurt sa nuk mund të jepet ushqimi. Gjithashtu përcakton fajsinë e ish-bashkëshortëve, ku bashkëshorti fajtor nuk ka të drejtë të kërkojë ushqim nga bashkëshorti tjetër. Fakti tjetër është se në qoftë se njëri bashkëshort me qëllim e krijon nevojshmërinë për ushqim, nëse kjo vërtetohet nga gjykata, atëherë kërkesëpadia refuzohet.

Ligji për Familje i RM-së refuzimin e kërkesëpadisë për ushqim si dhe pushimin e ushqimit i parashikon në nenin 188 dhe 191, ku për refuzimin e kërkesëpadisë për ushqim parasheh që: “gjykata mund që ta refuzojë kërkesën për ushqim nëse bashkëshortët në një periudhë më të gjatë sa kanë jetuar të ndarë, plotësisht në mënyrë të pavarur kanë siguruar mjete për ushqim, ose nga rrethanat e rastit vërtetohet se bashkëshorti që kërkon ushqim nuk është sjellë në gjendje më të vështirë material se sa ka qenë para lidhjes së martesës”<sup>153</sup>; ndërsa sa i përket pushimit të ushqimit parasheh “e drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon kur të pushojnë kushtet nga neni 185 i këtij ligji, kur të kalojë koha për të cilin është paraparë ushqim dhe kur

---

<sup>151</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.545

<sup>152</sup> Po aty, fq. 546

<sup>153</sup> Neni 188, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

bashkëshorti i mëparshëm që pranon ushqimin do të lidhë martesë të re gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtëmartesore.”<sup>154</sup>

Duke shiqur dhe analizuar, e drejta e pushimit të detyrimit për ushqim parashihet edhe në Kodin për Familje të Shqipërisë, në nenin 200, paragrafi 2, ku përcaktohet “Ky detyrim pushon para këtij afati, kur bashkëshorti që e gëzonte këtë të drejtë, lidhë martesë të re ose bëhet i aftë për punë, ose siguron mjete të mjaftueshme për të jetuar, ose kur gjykata, duke marrë parasysh rrethanat, çmon se nuk është i denjë për të përfituar nga kjo e drejtë.” Pra, ekzistojnë katër shkaqe të mbarimit të detyrimit për ushqim ndërmjet bashkëshortëve, për sa kohë ata janë gjallë. Këto shkaqe burojnë prej ndryshimit të situatave ose rrethanave të bashkëshortit përfitues si:

- lidhja e martesës së re;
- rifitimi i aftësisë për punë;
- sigurimi i mjeteve të mjaftueshme për jetesë;
- krijimi i rrethanave që e bëjnë të padenjë për të marrë detyrimin për ushqim.

Këto rrethana vlerësohen prej gjykatës rast pas rasti.<sup>155</sup> Sipas kësaj, **rasti i parë** i përfundimit të detyrimit për ushqim, është atëherë kur bashkëshorti i cili është përfitues nga detyrimi për ushqim lidhë një martesë të re, që nënkupton atë se me lidhjen e një martese të re bashkëshortët fitojnë të drejtë në detyrimin për ndihmë morale dhe materiale, me anë të së cilës përfituesi nga detyrimi për ushqim nuk do të ketë nevojë apo ndihmë materiale apo financiare, pasi që ajo do të plotësohet në lidhjen e martesës së re. Sipas **rastit të dytë**, ka të bëjë me rifitimin e aftësisë për punë, ku me anë të së cilës bashkëshorti përfitues i detyrimit për ushqim rifiton aftësinë për punë, që nënkupton se nga puna e caktuar do të ketë përfitime të caktuara dhe se nuk do të ketë të drejtë të kërkon detyrimin për ushqim nga bashkëshorti detyruar. Sipas **rastit të tretë**, sigurim i mjeteve të mjaftueshme për jetesë, nënkupton: thirrja në trashëgimi, fitimi i një lotarie të madhe, fitimi me dhurim i një sendi ose të drejte e cila është rentabël, etj.<sup>156</sup>, me anë të së cilës bashkëshorti përfitues siguron mjete të mjaftueshme për jetesë. **Rasti i katërt**, për krijimin e rrethanave që e bëjnë të padenjë për të marrë detyrimin për ushqim, ligjvënësi padenjësine e

---

<sup>154</sup> Neni 191, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së, “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>155</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, “Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.552

<sup>156</sup> Po aty, fq.553

përcakton në nenin 322<sup>157</sup> të KCSH-së. Ku gjykatësi në bazë të rrethanave të përcakton se bashkëshorti i cili është përfitues i detyrimit për ushqim, ka vrarë ose ka tentuar ta vrasë bashkëshortin i cili është detyrues për ushqiminë.

Nga ana tjetër, (sipas KCSH) çdo veprim poshtërues, keqtrajtues dhe fyes i rëndë, mund të përbëjë shkak që gjykata të çmojë në përputhje me rrethanat, së bashkëshorti përfitues nuk është i denjë për të përfituar në vazhdim nga e drejta për kërkimin e detyrimit ushqimor nga ish-bashkëshorti i tij/saj.<sup>158</sup>

---

<sup>157</sup> Në nenin 322 të Kodit Civil të Shqipërisë, nr. 7850, parashikohet shprehimisht: “Nuk mund të trashëgohet i padënjë: ai, që me dashje, ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij; ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjetë, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme me një gjykim penal; ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin, ose ka përpiluar vetë një testament të rremë, ose e ka përdorur për interesa të tijë ose të tjerëve; ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.”

<sup>158</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, ”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.554

### 1.3 Detyrimi në ushqim i prindërve të shkurorëzuar ndaj fëmijëve

Mbajtja e fëmijëve nga prindërit nënkupton përgjegjësinë e të dy prindërve që ti sigurojnë rregullisht fëmijës të mira materiale për plotësimin e nevojave për jetë.<sup>159</sup> Përveç detyrimit në ushqim të prindërve për fëmijën gjatë martesës ekziston detyrimi edhe pas zgjidhjes së martesës së prindërve. Neni 317 i LFK parasheh detyrimin e prindërve të pamartuar për t'i mbajtur fëmijët e tyre në mënyrë të njëjtë sikur prindërit e martuar.

Gjatë martesës bashkëshortët pamvarësisht marrëdhënieve të tyre personale, në shumë raste krijojnë familje. Në rastet të cilat martesa për shkaqe të ndryshme kërkohet që të zgjidhet, si pasojë sjell edhe ndarjen e fëmijëve nga njëri prindër. Mirëpo, kjo sipas ligjit është rregulluar detajisht. Në rast kur fëmija i takon njërit nga prindërit për edukim edhe kujdesje, prindërit të cilit nuk i takon kjo e drejtë, i takon e drejta në ushqiminë. Si dhe në rastet kur fëmija nuk i takon asnjërit nga prindërit për kujdesje, i takon një personi të tretë, atëherë janë të detyruar të dy bashkëshortët në ushqim të fëmijës së tyre të përbashkët. Gjitha ligjet janë përcaktuar ashtu që të mos dëmtohet fëmija. Prindërit mund që të merren vesh se kush do të kujdeset për fëmijën, mirpo në rast mosmarrëveshje, për këtë do të vendoset nga gjykata gjatë aktgjykimit me të cilin zgjidhet martesa.

Për procedurën në kontestet për ushqim në Ligjin për Familjë të RM-së në nenin 274 parasheh: “Me aktgjykimin me të cilin martesa anulohet ose shkurorëzohet, gjykata do të sjell vendim për ushqimin e personave të caktuar në nenin 179<sup>160</sup> të këtij ligji.”

Neni 196 në paragrafin 2 të Kodit të Familjes së Shqipërisë përcakton shprehimisht: “prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t’u jetë hequr e drejta prindërore”. Kjo nënkupton atë se nëse fëmijëve ju është hequr krejtësisht e drejta prindërore, prindërit duhet që të mbajnë fëmijën e tyre më anë të ushqimimit.

Sipas LPDTS, neni 78, parag.1 “në rastet kur prindërit e fëmijës nuk jetojnë sëbashku, atëherë merren vesh se te cili prej tyre do të qëndrojë fëmija për ruajtje dhe edukim, dhe nëse ata

---

<sup>159</sup> Aliu Abdulla, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, fq.310

<sup>160</sup> Neni 179, “prindërit janë të obliguar të ushqejnë fëmijët e tyre”, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32



nuk mund të merren vesh ose marrëveshja e tyre nuk i përgjigjet interesave të fëmijëve, aktvendim për këtë do të sjellë Qendra për punë sociale.<sup>161</sup>

Sa i përket ushqimisë për kujdesin e fëmijës, LFK në nenin 299 parasheh: “Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj”. Ky nen sqaron se çfarë të drejte ka prindi të cilit i takon e drejta e kujdesjes dhe mbajtjes së fëmijës, të kërkojë nga prindi tjetër alimentacion, sepse mbajtja dhe kujdesi për fëmijën nuk i lejon kohë që të punoj, sepse për kujdesin e fëmijëve duhet që të ju përkushton shumicën nga koha e tij/saj.

Në Ligjin për familje të Kosovës ekzistojnë dispozita të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve të prindërve të pamartuar. Këto dispozita i parasheh si detyrimet e babait të pamartuar, në nenin 317 ku përcakton: “Baba i fëmijës është i detyruar të jap mbajtje financiare gjatë intervalit kohorë prej 6 javësh para lindjes së fëmijës dhe tetë javësh pas lindjes së fëmijës; Kjo është e lidhur gjithashtu me të gjitha shpenzimet e shtatëzarisë dhe lindjes së fëmijës; Përderisa nëna nuk mund të sigurojë marrëdhënie të punës përshkak të sëmundjes së shkaktuar nga shtatëzania apo nga lindja, detyrimi për të siguruar mbajtje financiare për fëmijën dhe ushqimin për gruan mund të zgjatet; E njëjta do të aplikohet nëse nëna nuk mund të punojë për shkak të kujdesit dhe mirërritjes së fëmijës; Kjo do të aplikohet gjithashtu në rastet kur fëmija ka lindur i vdekur apo ka vdekur pas lindjes apo gjatë paaftësisë së fëmijës se shkaktuar me lindje.” Me këtë nen me pesë paragrafe, shumë me kujdes ligjvënësi e ka rregulluar gjendjen e gruas së shkurorëzuar dhe njëkohësisht shtatëzane. Ky ligj rregullon dhe të njëjtën kohë mbron të drejtat e fëmijës së paralindur apo posalindur. Kjo nënkupton se gruaja e shkurorëzuar e gëzon këtë të drejtë personale, gjatë shtatëzarisë, me qëllim që me anë të detyrimit për ushqim nga ana e ish-bashkëshortit, të realizon të mira material për fëmijën e përbashkët të tyre.

Gjithashtu në nenin 320 të LFK-së përfshihen detyrimet e nënës së pamartuar, ku ligjvënësi ka përcaktuar “Nëse babai është i detyruar për kujdesin dhe edukimin e fëmijës ai mund të kërkojë mbajtje financiare të cekur në nenin 317<sup>162</sup> paragrafi 4.” Në këtë nen përcaktohet e drejta e ish-bashkëshortit të cilit i takojnë fëmijët për kujdes dhe edukim të fëmijës

---

<sup>161</sup> Neni 78, paragrafi 1, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>162</sup> Neni 317, Paragrafi 4 “ E njëjta do të aplikohet nëse nëna nuk mund të punojë për shkak të kujdesit dhe mirërritjes së fëmijës.”, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

që të kërkoj ushqimin nga ish-bashkëshortja, me arsye se ai nuk mund të punoj për shkak të kujdesit dhe mirrëritjes së fëmijëve.

Kur gjykata konstaton se prindërit nuk kanë mundësi që t'i përmbushin nevojat e ushqimit të fëmijës së mitur, ajo duhet ta informojë për këtë rrethanë organin e kujdestarisë. Ky ka të drejtë që në këtë rast, në emër të fëmijës ka të drejtë ta zgjerojë padinë për ushqim me persona të tjerë, që sipas ligjit, kanë për detyrë të japin ushqimin. Këta persona nuk mund t'i bëjnë kundërshtim zgjerimit të padisë.<sup>163</sup>

Ka raste kur prindërit e fëmijës së përbashkët nuk kanë mundësi që t'i përmbushin detyrimet në ushqimin ndaj tij. Kjo për arsye të cilat mund të jenë të ndryshme, si mungesë e të mirave materiale, paaftësia për punë, shkollim jo të lartë për tu cilësua në marrëdhënie pune, etj., nga të cilët prindërit e shkurorezuar me gjendje të njejtë nuk kanë mundësi në përmbushjen e detyrimit në ushqim ndaj fëmijës. Gjykata duke analizuar rrethanat për këto raste njofton kujdestarin e fëmijës i cili është organ kompetent, i cili ka të drejtë të kërkojë ushqimin nga persona të tjerë që kanë për detyrë të japin ushqimin, sipas ligjit. Këta janë familjarë të fëmijës, si përshëmbull: gjyshi, gjyshja, etj. Sipas ligjit këta persona nuk mund ta kundërshtojnë padinë.

Të drejtat e fëmijëve janë të mbrojtura ndërkombëtarisht. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve në nenin 3 par.1 përmbanë “në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët të marra nga institucionet private apo publike të mirëqenies shoqërore, gjykatave apo autoriteteve administrative apo organeve legjislativë, interesat më të mirë të fëmijës do të jenë në konsideratë primare”.<sup>164</sup>

Sipas Kuranit të Shejntë në Suren El Bekare 233 parasheh se “Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t'u japin gjë fëmijëve të vet dy vjet të plota. I ati i fëmijës është i obliguar për furnizim dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull. Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa ka mundësin e tij. Asnjë nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Po ashtu është i obliguar edhe trashëgimtari (i fëmijës). E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) e gjinit, nuk është ndonjë mëkat për ta. Nëse ju baballarët për fëmijën tuaj dëshironi gjidhënese tjetër me

<sup>163</sup> Brestovci Faik, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2004, fq.125

<sup>164</sup> Gjykimi i rasteve në Kosovë: çështjet lidhur me menaxhimin e lëndës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, 2011

kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur, nuk është ndonjë mëkat. Kini frikë nga All-llahu dhe dijeni se All-llahu sheh çka punoni".<sup>165</sup>

Në këtë sure është përfshirë gruaja e cila nuk duhet që të dëmtohet përshak të fëmijës, ta mbajë me ushqim deri sa të ketë mundësi, si dhe gjithashtu edhe burri që të kujdeset për fëmijën deri sa të ketë mundësi për ta realizuar kujdesin për fëmijën. Pra këtu fëmija nuk parashihet si subjekt primar për të pasur kujdes ndaj tij, siç parashihej ndërkombëtarisht. Në të drejtëm islame i gjithë kujdesi që duhet dhënë dhe ushqimia ndaj fëmijëve duhet bërë në bazë të mundësive të prindërve, pa i dëmtuar ato.

Të drejtat e fëmijëve gjithmonë duhet të jenë primare, çka do që të ndodhë në mes prindërve, fëmija është i pafajshëm dhe për këtë shkak nuk duhet që fëmija të lëndohet apo të dëmtohet. Në rast se prindërit nuk kanë zgjidhje tjetër nga një martesë e pasuksesshme atëherë do të përfundojnë martesën me shkurorëzim, ku i cili me vete sjell një sërë pasojash të mëdha që janë të përherëshme. Është lehtë të pushon një martesë me anë të shkurorëzimit, por është vështirë të përballesh me pasojat që sjell pushimi i martesës me anë të shkurorëzimit. Si shembull kryesor i pasojave që sjell shkurorëzimi është ndarja e fëmijës nga njëri prindër. Në bazë të rrethanave gjykata do të përcakton se cilit prindër do ti takon fëmija për përkujdesje. Prindi që mund të jetë nëna e tij, mund që mos të ketë të mira materiale për tu kujdesur dhe të edukon fëmijën, por gjykata mund të marrë vendimin dhe ta ketë më të arsyeshme që nëna të kujdeset për fëmijën, atëherë ajo do të ketë të drejtë në kërkesën në detyrimin për ushqim. Për të mos e dëmtuar fëmijën prindi i cili mund të jetë babai, ku sipas gjykatës nuk do ta fitonte të drejtën për përkujdesjen e fëmijës, në rast të mundësisë është i detyruar që të jep ushqiminë.

Neni 197 i KFSH përcakton detyrimin e prindërve të ushqejnë fëmijët e tyre: "Prindërit kanë detyrim për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar."<sup>166</sup> Detyrimi për ushqim lidhet me tri elemente objektive, 1) fëmija është bërë madhor; 2) fëmija është duke ndjekur shkollën e mesme ose të lartë; 3) fëmija nuk ka mbushur ende 25 vjet.<sup>167</sup> Normalisht, detyrimi ushqimor vazhdon deri sa fëmija arrin moshën madhore (lidhet me

---

<sup>165</sup> Suren El Bekare 233, Kur'an

<sup>166</sup> Neni 197, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

<sup>167</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,"Kristalina KH", Tiranë, 2006, fq.556

ushtrimin e përgjegjësive prindërore), mirëpo edhe pas kësaj moshe mund të caktohet detyrimi ushqimor, nëse janë kushtet e parashikuara shprehimisht në ligj.<sup>168</sup>

Sa i përket mbajtjes së fëmijëve nga prindi, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përcakton masa urgjente në rast se njëri prind nuk e përmbush detyrimin për ushqim ndaj fëmijës dhe vë në rrezik fëmijën, ku në nenin 61, paragrafi 1 dhe 2 përcakton shprehimisht: “Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit tjetër mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me ta. Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet.”<sup>169</sup>

Në bazë të legjislacioneve bashkëkohore, në mënyrë shumë të lehtë dhe të sakt kuptojmë rolin e fëmijës në marrëdhëniet familjare. Pamvarësisht marrëdhënieve bashkëshortore, gjithmonë vëmendje të veçantë ju kushtohet fëmijëve, të cilët më shumë vëmendje ju përkushtohet në rast të shkurorëzimit të prindërve, të përcaktohet nga ana e gjykatës se cilit prindë do ti takon përkujdesi për fëmijën, si dhe në rast që prindi i përcaktuar për përkujdesjen e fëmijës (që në të shumtën e rasteve është gruaja) nuk ka të mira material të cilat do të kontribuonin për përkujdesjen e fëmijës, ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim nga detyruesi i detyrimit për ushqim.

---

<sup>168</sup> Po aty, fq.556

<sup>169</sup> Neni 61, parag.1,2, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

#### 1.4 Detyrimi i përfituesit të dhurimit

Përfituesi i dhurimit, në parapëlqim kundrejt çdo të detyruari tjetër, detyrohet t'i japë dhuruesit detyrimin për ushqim, përveçse kur bëhet fjalë për dhurim të bërë lidhur me një martesë ose për një dhurim me kusht.<sup>170</sup>

Përfituesi i dhurimit është bashkëshorti i cili i kërkon nga i detyruari apo bashkëshorti që ka mundësi të jep detyrimin për ushqim. Përfituesi i detyrimit ka për detyrë që të kërkojë nga bashkëshorti detyrimin për ushqim. Por shumë më rëndësi është që përfituesi i detyrimit për ushqim, të ketë nevojë për të mira materiale për jetesë, duke u arsyetuar me paaftësinë nga e cila nuk mund t'i fiton këto të mira materiale. Nga ana tjetër, bashkëshorti i cili është i detyruar për dhënien e ushqimit ndaj kërkuesit të saj, duhet që të ketë mundësi për të dhuruar atë.

Kodi i Familjes së Shqipërisë përcakton atë se, në rastin e dhurimit, përfituesi i tij nuk mund të detyrohet më shumë se vlera e pasurisë së dhuruar që ekziston në pasurinë e tij.<sup>171</sup> Ndërsa sipas Kodit Civil të Shqipërisë, dhuruesi, për dhurimet që nuk janë të zakonshme ose që nuk janë bërë për shpërblim, mund të kërkojë revokimin e dhurimit kur ai që ka marrë dhurimin: a) me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët, ose prindërit e tij; b) pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim kur është i detyruar sipas ligjit.<sup>172</sup>

Neni 202 i Ligjit të Familjes së RM-së, ku detyruesin e përcakton si ushqimdhënësi, përcakton se: “Ushqimdhënësi (organi, organizatat, bashkësia apo personi fizik) ka mundësi që nga personat të cilët sipas këtij ligji kanë qenë të obliguar që të japin ushqimin, me padi kërkojnë kompenzimin e shpenzimeve të bëra për ushqim të personit në qoftë se ato kanë qenë të arsyeshme.”<sup>173</sup>

LFK në nenin 321 përcakton atë se kurë nga gjykata bëhet refuzimi i kërkesës së bashkëshortit që kërkon detyrimin për ushqim: “Gjykata mund të refuzojë kërkesën për ushqimi vetëm nëse kërkuesi është fajtor për fyerje të rëndë të paramenduar kundër partnerit.”

---

<sup>170</sup> Neni 193, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

<sup>171</sup> Po aty, Neni 202

<sup>172</sup> Neni 771, Kodi Civil i Shqipërisë, Nr.7850

<sup>173</sup> Neni 202, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

## 1.5 Pamundësia e dhënies së detyrimit për ushqim

Dhënia e detyrimit për ushqim kërkohet pas shkurorëzimit të martesës nga bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për jetë. Megjithëse, legjislacionet kanë paraparë dispozita të cilat përcaktojnë edhe pamundësinë e dhënies së detyrimit për ushqim të bashkëshortit i cili është detyruar të jep atë. Sipas LFM-së, neni 194, parag.3 “Gjatë vërtetimit të mundësive të personit i cili është i obliguar të jep ushqim, gjykata do t’i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij, nevojat e personale të tija dhe obligimet ligjore të tija në ushqim të personave të tjerë.”<sup>174</sup>

Sipas LFK, neni 307, parag.1 dhe 2, parasheh:”Personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet tjera nuk janë në gjendje të japin ushqimin pa rrezikuar mbajtjen e tyre të arsyeshme, nuk janë të detyruar të japin mbajtjen. Detyrimi mbetet për aq sa ata janë në gjendje të sigurojnë ushqimin.

Ndryshe nga LFM dhe LFK, në KFSH detyrimi për ushqim në rast të pamundësisë së përmbushjes së detyruesit u kalon personave në radhë të mëpasme. Kodi për Familjen i Shqipërisë pamundësinë e përcakton shprehimisht në nenet 196 dhe ngjajshem në nenin 204 parag.2: “Kur personat e ngarkuar për dhënien e detyrimit për ushqim nuk janë në gjendje ta japin këtë tërësisht ose pjesërisht, ky detyrim u kalon tërësisht ose pjesërisht personave që janë në radhë të mëpasme. Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t’u jetë hequr përgjegjësia prindërore.”<sup>175</sup> “Nëse personat e thirrur në një shkallë të mëparshme nuk janë në gjendje ta përballojnë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për ushqim, ky u kalon plotësisht ose pjesërisht personave të thirrur në një shkallë të mëpasshme.”<sup>176</sup> Në rast se personi që detyrohet për dhënien e detyrimit për ushqim, nga pikëpamja ekonomike, është i pamundur tërësisht ose pjesërisht që ta japë këtë detyrim, atëherë ai do t’u kalojë tërësisht ose pjesërisht personave të thirrur në një shkallë të mëpasme.<sup>177</sup>

Arsyet e pamundësisë ekonomike mund të jenë të ndryshme, mirëpo me rëndësi për gjykatën është se a ekziston ose jo mundësia që i detyruar të jep ushqimin ndaj bashkëshortit tjetër.

---

<sup>174</sup> Neni 194, parag.3, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim:Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>175</sup> Neni 196, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

<sup>176</sup> Po aty, neni 204, parag.2

<sup>177</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.565

## 1.6 Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim

Njëri nga bashkëshortët duke u bazuar në ligj, ka të drejtë që të ndërpresë, të zvogëlojë ose të rrisë detyrimin për ushqim. Këtë ka të drejtë t'a kërkon personi i interesuar nga gjykata. Gjykata në bazë të rrethanave do të merr vendim të ri të formës së prerë. Heqja e detyrimit për ushqim bëhet nga gjykata atëherë kurë nuk ekzistojnë më rrethanat të cilat e arsyetojnë vendosjen e këtij detyrimi. Pakësimi i detyrimit për ushqim bëhet nga gjykata duke u bazuar në dy raste: në zvogëlimin e nevojave të personit që ka kërkuar detyrimin për ushqim, ose në zvogëlimin e mundësisë personit i cili është i detyruar të jepë këtë detyrim. Shtimi i detyrimit për ushqim bëhet nga gjykata duke u bazuar në dy raste: në shtimin e nevojave të personit që ka kërkuar detyrimin për ushqim, ose në shtimin e mundësisë personit i cili është i detyruar të jepë këtë detyrim.

Ligji për Familjen i Republikës së Maqedonisë, neni 201 përcakton atë se: “Personi i interesuar mund të kërkojë që gjykata të rrisë, zvogëlojë apo ta ndërpresë ushqimin e përcaktuar më herët me aktgjykim të plotëfuqishëm nëse kanë ndryshuar rrethanat në bazë të të cilëve është sjellur aktgjykimi.”<sup>178</sup>

Sipas legjislacionit shqipëtar, Kodi i Familjes së Shqipërisë për heqjen, pakësimin ose shtimin e detyrimit për ushqim, neni 207 përcakton shprehimisht: “Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë. Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë. Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi. Në këtë rast, personi i detyruar në shkallën e mëpasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme.”<sup>179</sup> Gjykata do të pakëson, heqë ose shton detyrimin për ushqim të caktuar me vendim të formës së prerë, me kërkesën e personit të interesuar, atëherë kur rrethanat për të cilat është marrë vendimi kanë ndryshuar më vonë.

<sup>178</sup> Neni 201, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>179</sup> Neni 207, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

## 1.7 Pushimi i detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim mund që edhe të pushon nga vendimi i gjykatës duke u bazuar në ligj si edhe në rrethanat e rastit të caktuar. Për të kërkuar ushqiminë bashkëshorti duhet që të ketë nevojë për këtë, ndërsa bashkëshorti tjetër për të përmbushur detyrimin duhet që të ketë mundësi, të konstatohet gjendja ekonomike e bashkëshortit të shkurorëzuar që kërkon detyrimin për ushqim, se si e ka pasur gjendjen ekonomike gjatë martesës dhe pas pushimit të martesës. Detyrimi për ushqim ka natyrë vetjake sepse është i lidhur ngushtë me personin që e kërkon detyrimin si dhe me personin që është i detyruar të jep këtë detyrim.

Ligji për Familje i RM-së, për pushimin e detyrimit për ushqim parasheh në nenin 191, ku përcakton se e drejta e bashkëshortit të mëparshëm për ushqim pushon kur të pushojnë kushtet nga neni 185<sup>180</sup> i këtij ligji, kur të kalojë koha për të cilën është paraparë ushqimia dhe kur bashkëshorti i mëparshëm që pranon ushqiminë do të lidhë martesë të re, gjegjësisht do të hyjë në bashkësi jashtëmartesore.

LFK, neni 312 për shuarjen e të drejtës së ushqimisë përcakton atë se: “E drejta e bashkëshortit të shkurorëzuar për alimentacion pushon:

- kur kushtet nga nenet 298-302<sup>181</sup> të këtij ligji nuk zbatohen më,
- kur koha për të cilën gjykata ka përcaktuar alimentacion kalon,
- kur bashkëshorti i shkurorëzuar i cili gëzon këtë të drejtë ri-martohet ose hyn në bashkësi jashtëmartesore (bashkësi faktike) ose
- bashkëshorti i cili gëzon këtë të drejtë vdes.<sup>182</sup>

Detyrimi për ushqim pushon me vdekjen e personit të detyruar, personit që e përfiton atë, edhe sikur ky detyrim, që përmbahet në një vendim të formës së prerë, të mos jetë ekzekutuar.<sup>183</sup> Përcaktuar kështu nga neni 212 i KFSH-së, nënkuptojmë atë se nëse njëri nga këta persona vdes,

---

<sup>180</sup> Neni 185, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së, “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014: “Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim dhe është i paaftë për punë ose është i papunë pa fajin e vet, ka të drejtë në ushqim nga ana e bashkëshortit të vet në proporcion me mundësitë e tij.”

<sup>181</sup> Neni 298, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32: “Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare.”

<sup>182</sup> Neni 312, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>183</sup> Neni 212, Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003



atëherë pushon detyrimi për ushqim ndaj njëri tjetrit. Ky është një dallim thelbësor me detyrimet e tjera që mund të rëndojnë mbi persona të caktuar. Kështu, p.sh., nëse dhënësi i detyrimit për ushqim vdes, trashëgimtarët e tij nuk kanë asnjë detyrim për ushqim ndaj personit që përfitonte.<sup>184</sup> Për shkak se me vdekjen e njërit nga bashkëshortët qoftë detyruesi ose përfituesi i detyrimit për ushqim, mbaron zotësia juridike, si dhe me vdekjen e tij nuk mund të jetë mbartës i të drejtave dhe detyrimeve juridiko-civile.

### **1.8 Procedura e detyrimit për ushqim**

E drejta e mbajtjes dhe ushqimisë është e përcaktuar me ligj. Ligjvënësi ka përcaktuar shumë sakt se çfarë të drejte në alimentacion kanë bashkëshortët dhe fëmijët duket plotësuar kushtet të cilat janë paraparë me ligj. Për procedurat e mbajtjes dhe ushqimisë është kompetente gjykata me kompetencë të përgjithshme territoriale ose në gjykatën në territorin e të cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Këtë e parasheh LFK në nenin 323 për kompetencën territoriale, ku parasheh se: “Në kontestet për ushqimi, fëmija përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqet padi në gjykatën me kompetencë të përgjithshme territorial ose në gjykatën në territorin e të cilës paditësi e ka vendbanimin osë vendqëndrimin.”<sup>185</sup>

Procedura për kontestin e ushqimisë në instancën e parë gjyqësore drejtohet dhe vendoset nga kolegji gjyqësor i përbërë nga një gjyqtar dhe dy gjyqtarë porotë, kurse në instancën e dytë gjykata përbëhet nga kolegji prej tre gjyqtarësh.<sup>186</sup>

Konventa Ndërkombëtare, në nenin 3, paragrafi 1 përcakton “1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjilative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore”.<sup>187</sup> Gjykata për vendimet gjatë procedurës së mbajtjes

---

<sup>184</sup> Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare, ”Kristalina KH”, Tiranë, 2006, fq.568

<sup>185</sup> Neni 323, Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

<sup>186</sup> Gashi Haxhi, Aliu Abdulla, Vokshi Adem, Komentari i Ligji nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, , Prishtinë, 2012 fq.669

<sup>187</sup> Gashi Haxhi, Aliu Abdulla, Vokshi Adem, Komentari i Ligji nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, , Prishtinë, 2012 fq.671

dhe ushqimit vendos *ex officio* , për të mbrojtur interesat e fëmijëve. Këto vendime janë vendime të cilat merren pamvarësisht kërkesave të bashkëshortëve, ku gjykata ka për qëllim kryesor mos të dëmtohen fëmijët.

Në kontestet familjar, palët në procedurë preferojnë të aplikohet parimi i përjashtimit të publikut, për arsye se kontestet familjare përmbajnë probleme të jetës private, ofenduese, të cilat prekin dinjitetin dhe integritetin personal të njeriut.

### **1.8.1 Përcaktimi i ushqimit sipas gjykatës**

Ligji për Familjen i RM-së parasheh përcaktimin e ushqimit në nenet 194-202. Gjatë përcaktimit të nevojës për ushqim të personit, gjykata do të merr parasysh gjendjen e tij pronësore, aftësinë për punë, mundësinë për punësim, gjendjen shëndetësore, si dhe rrethanat e tjera nga të cilat varet vlerësimi mbi nevojat e tij.<sup>188</sup> Për të përcaktuar ushqiminë, gjykata do të merr parasysh rrethanat e bashkëshortit, për të vërtetuar nevojën për ushqiminë të bashkëshortit i cili e kërkon atë, si dhe të vërteton faktin se a ka mundësi që i detyruari në ushqim të japë atë. Kur përcaktimi i ushqimisë bëhet për fëmijë, gjykata do të marrë parasysh edhe moshën e fëmijës si edhe nevojat për shkollimin e tij. Gjatë vërtetimit të mundësive të personit i cili është i obliguar të japë ushqim gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij, nevojat e tija personale dhe obligimet e tija ligjore në ushqim të personave të tjerë.<sup>189</sup>

---

<sup>188</sup> Neni 194, paragr. 1, Zakon za Semejstvoto na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së , “Sluzben Vesnik”, br.153, 2014

<sup>189</sup> Po aty, Neni 194, paragr. 2, 3

## KREU I TETË

### PËRFUNDIMI

Nga analiza e të gjithë legjislacioneve, nocioneve si dhe fakteve të ndryshme nga praktika gjyqësore si dhe statistikat e dhëna në këtë punim, bëjnë që të kuptojmë se në çfarë pozite juridiko-pasurore pas shkurorëzimit rënditet gruaja.

Duke bërë krahasimin e legjislacioneve që nga zhvillimet historike të pozitës juridiko-pasurore të gruas pas shkurorëzimit të martesës, deri në legjislacionet bashkëkohore, të drejtat e gruas kanë pësuar një ndryshim rrënjësor në formalitet. Mirëpor, megjithëse ligjet janë të formuluar në mënyrë të sakt, problematika që hasën gruaja gjatë ndarjes së pronësisë së përbashkët nga ish-bashkëshorti, qëndron nga praktika gjyqësore.

Edhe pse fjala “punë” nuk përfshihet në nenet e LPDTS (66-80), ligjvënësi e përdor në masë të madhe, si dhe gjykatat gjatë përcaktimit të pasurisë së përbashkët në ndarjen e saj për bazë juridike marrën punën e bashkëshortëve, si edhe punët e tjera të amvisërisë, mirëmbajtjen dhe edukimin e fëmijëve dhe shtimin e pasurisë. Sikur të gjykohej rasti bazuar në ligj do të ishte në rregull pozita e gruas pas ndarjes së pasurisë së përbashkët.

Megjithëse, gjykata nga pasiviteti i saj që e ka problem matjen e kontributit në shifra që gruaja i ka dhënë për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve, mirëmbajtjen e shtëpisë, shtimin e pasurisë, në të gjitha rastet e ndarjes së pasurisë së përbashkët të një gruaje amvise, gjykata do të gabon, vërtetuar kjo nga rastet të cilat janë trajtuar në temë. Ligjvënësi premtan se do të merr parasysh situatën e amviseve, gjyqtari nuk e respekton atë në fund. Me faktin se shumica e grave shqiptarë në Maqedoni janë të papunësuar, kjo nuk domethënë se ajo nuk kontribuon në shtimin e pasurisë së përbashkët.

Gjykata duhet të ketë parasysh të gjithë këto fakte të një gruaje amvise gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët nga bashkëshorti: a) mirëmbajtjen e shtëpisë (pa të cilën do të vjetërohet); b) kujdesin dhe rritjen e fëmijëve, edukimin e fëmijëve, ndihmën e fëmijëve për përkujdes të veçantë të tyre gjatë mësimeve shkollore, kujdesi për moslëndimet e fëmijëve (llogaritur këtë me një të punësuar në qendrën për edukimin e fëmijëve); c) përgatitja e ushqimeve ( të cilën mund t'a llogaritim në bazë të çmimeve me llogarinë e ushqimeve të restoranteve), përkujdesi ndaj

mirëmbajtjes së burrit, marrëdhëniet intime mes burrit dhe gruas (periudha kohore gjatë të cilës është shfrytëzuar gruaja), përkujdesi ndaj mirëmbajtjes së prindërve të burrit, mirëpritja e familjarëve të burrit; d) shtimi i pasurisë në bazë të këshillave ndaj burrit, etj.

Krahasuar legjislacionet e Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës me atë të Republikës së Shqipërisë, në këtë të fundit legjislacioni përmbanë sistemin e regjimit pasuror ligjor dhe regjimit pasuror të kontraktuar, ku legjislacionet e Maqedonisë dhe Kosovës nuk e përfshijnë regjimin e pasurisë së kontraktuar. Kjo është problemi tjetër apo do të ishte zgjidhja e problemit sikur në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kosovës të përfshihej edhe regjimi pasuror i kontraktuar si një alternativë tjetër për bashkëshortët për rregullimin e pasurisë së tyre të përbashkët.

Secila martesë e bashkëshortëve për nga natyra janë të ndryshme, ekzistojnë raste kur martesa është efektive dhe nuk pushon, si dhe ekzistojnë raste të cilat janë edhe në rritje e sipër ku bashkëshortët shkurorezohen. Andaj një sistem vetëm me regjim pasuror ligjor të cilit duhet ti nënshtrohen bashkëshortët detyrimisht nuk do të ishte i përshtatshëm për të gjitha rastet njejtë ashtu siç duhet.

Sikur të ekziston sistemi i regjimit pasuror të kontraktuar, atëherë gruaja nuk do të ishte e mvarur në aspektin financiar, dhe në një farë mënyre do të ketë pavarsinë e saj dhe do të rritet në të njejtën pozitë në të cilën gjendet burri.

## Referencat

### Tekste, monografi, artikuj

1. Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007
2. Begeja Ksanthipi, E drejta familjare e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985
3. Begeja Ksanthipi, E drejta martesore e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985
4. Brestovci Faik, E drejta e procedurës civile II, Prishtinë, 2004
5. Cavdar Kiril, Komentari na Zakonot za semejtvo, Skopje, 1980
6. Elezi Ismet, Kanuni i Labërisë, "Toena", 2002
7. Gelevski Sllavko, Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, so komentar I sudska praktika, Skopje, 2002
8. Gashi Kushtrim, Shkaqet dhe Pasojat e Shkurorëzimit në Kosovë, 2015, <https://telegrafi.com/shkaqet-dhe-pasojat-e-shkurorëzimit-ne-kosove/>
9. Gashi Haxhi, Aliu Abdulla, Vokshi Adem, Komentari, Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji nr.2004/32, Prishtinë 2012
10. Gjecovi Shtefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit
11. Gjykimi i rasteve në Kosovë: çështjet lidhur me menaxhimin e lëndës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, 2011
12. Hoxha Shefqet, E Drejta Dokesore: Kanuni i Lumës, Tiranë, 2013
13. Janevski Arsen, Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedurale civile, Libri i parë, E drejta kontestimore, Shkup, 2011, përkthim: Zendeli Emine - Zendeli Nagip
14. Mandro-Balili Arta, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E Drejta Familjare,"Kristalina KH", Tiranë, 2006
15. Mickoviq Dejan, Ristov Angel, Semejno Pravo, Skopje, 2015
16. Podvorica Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005
17. Verdish Martin-Klaric Petar, Gragjansko parvo, Zagreb,1998
18. Zendeli Emine, Zendeli Nagip, Perspektiva e Rregullimit të Marrëdhënieve Pasurore të Bashkëshortëve në Sistemin Juridik të Republikës së Maqedonisë, Shoqata e intelektualeve "Klubi demokratik"-Shkup, Gjilan, 2014
19. Zendeli Emine, Risitë e ligjit mbi procedurën jokontestimore, Vizione 11/12, Shkup, 2009

20. Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130

### **Akte ligjore, kode**

Kodi i Familjes i Shqipërisë, LIGJ Nr.9062, 2003

Kodi Civil i Shqipërisë, Ligji Nr.7850,2003

Ligji për Familjen i Kosovës, nr.2004/32

Ligji për procedurë jokontestimore, ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 9/2008)

Ligji për procedurë kontestimore ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 79/2005)

Zakon za obligacionite odnosi "Sluzben Vesnik" na RM, br.53/2001

Zakon za promet so zemjishta i zgradi, "Sluzben Vesnik" na RM, br.4/1993

Zakon za Sopstvenost I drugi stvarni prava, me përkthim: Ligjit për Pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së 2001

Zakon za vonparnicna postapka, me përkthim: Ligji për procedurë jokontestimore, ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 9/2008)

Ligji për marrëdhënie detyrimore ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 53/2001")

Ligji për falimentim ('Gazeta zyrtare e RM-së' nr. 34/2006)

Semejno Pravo na RM, me përkthim: Ligji i Familjes i RM-së, "Sluzben Vesnik", br.153, 2014

Kur'an, Suretu El Bekare

## Praktika gjyqësore

1. Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na osnoven sud Tetovo, P.br. 423/1997, 15.10.1997
2. Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na Osnovniot sud Skopje II, 05.06.2007 VIII П.6p. 250/05
3. Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.9, Presuda na Osnovniot sud Skopje II, 05.06.2007 VIII П.6p. 250/05
4. Zendeli, E., 2012. Ndarja e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurë gjyqësore- Rasti i Maqedonisë. Jeta Juridike, Nr. 4, Shkolla e Magjistratures, Tirane, p. 115-130, fq.12, Odluka na Vrhovniot sud na Makedonija, Rev.br. 21/90 „Zbirka na sudski odluki”, kniga IV, obl. 3
5. Satatistika për numrin e lëndëve të shkurorëzimit nga Gjykata Themelore e Tetovës, 15.11.2017
6. Gashi Kushtrim, Shkaqet dhe Pasojat e Shkurorëzimit në Kosovë, 2015, <https://telegrafi.com/shkaqet-dhe-pasojat-e-shkurorezimit-ne-kosove/>